



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 E 22 SHTATOR DHE 1 E 8 TETOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. I 22. SEPTEMBRA I 01. I 08. OKTOBRA 2015. GODINE**

**SHTATOR/TETOR - SEPTEMBAR/OKTOBAR
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015,
5. Interpelanca e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Memli Krasniqi,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
8. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
9. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
10. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Izveštavanje vlade Republike Kosova o postignutim sporazumima u Briselu, 25. avgusta 2015. god,
5. Interpelancija ministra za Poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj, g-dina Memli Krasniqi,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ličnoj karti,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o geografskim oznakama i imenima porekla,
8. Imenovanje članova Saveta za besplatnu pravnu pomoć,
9. Imenovanje člana Komisije za imovinske zahteve,
10. Formiranje Komisije ad hoc za izbor člana Borda RTK-a od strane srpske Zajednice.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Kolegë deputetë,
Ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Ju shpreh mirëseardhje në këtë seancë të fillimit të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke ju dëshiruar punë të suksesshme.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për deklarime ose diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën në momentin kur ta marrin fjalën. Pra, këto janë rregullat dhe është mirë të ju përmbahemi dhe do t'u përmbahemi.

Fjalën e ka deputeti Ramush Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ: Përshëndetje kolegë deputetë,
Kryesues, media,

E para, shfrytëzoj rastin me urua veteranët që kanë marrë certifikatë dhe që janë pranua si veteranë. Por, e kam një pyetje, qenka edhe kryetari i komisionit këtu për shtabet lokale.

Në Dukagjin e dini besoj të gjithëve, kush ku i ka interesua ku i intereson, ekzistojnë shtabe lokale, të katundeve, vendbanimeve UÇK që kanë filluar me operua në mars të vitit '98. Nuk e dimë pse nuk po përfshihen ose nuk po pranohen si veteranë. Me thanë se ligji është bërë i tillë që pranon vetëm 90 ditët e fundit kush ka qenë në luftë, besoni këta njerëz kanë qenë në luftë gjithë kohën por evidencat për këta janë ndryshe. Pse? Për shembull në rast se e marrim një vendbanim cilido qoftë Mazhnik një vendbanim i huptë. Ai edhe pas shtatorit, edhe në kohë të bombardimeve ka qëndruar në Kosovë, por nuk ka mund me qenë pjesë e njërive, ata kanë qenë në vendbanime të veta, ngryke, në periferi. Të gjithë këta njerëz që kanë bërë shumë për luftën është e padrejtë të mbeten jashtë.

Ju lutem kryetari i Komisionit zoti Çeku, kolegëve tjerë unë ua kam bërë një deklaram publik edhe nënshkrim që i marrë përgjegjësitë edhe dëshmojë që këta janë veteranë. Pra, në rast se duhet dikush me dhënë përgjegjësi para ligjit jap unë, ju mos u frikoni në rast se me plot gojën më keni dërguar komandant zone kur keni folur për këto treva, atëherë unë jap nënshkrim, e kam dhënë, janë veteranë, aplikoni. Në rast se dikush më kërkon përgjegjësi unë jam në gjendje... Po pse atëherë nuk po ndodh, nuk e kuptoj. Më falni, shpresoj që bëhet. Faleminderit!

Sot kemi pritë me fol për disa tema, po e shoh që rrjedha e seancës është tjetër, po kursena për më vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haradinaj! Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të provoj të flas shkurt, mirëpo do të ngre tri çështje, të cilat janë shumë me rëndësi.

Çështja e parë është edhe në bashkëbisedim edhe me Komisionin për Arsim, është problemi i çantave të rënda shkollore të fëmijët e cikleve të ulëta. Është një problem të cilën unë që tre vjet në vazhdimësi e ngre këtu në Kuvend, mirëpo i cili nuk po merr zgjidhje. Përkundër një iniciative e cila ka qenë në komunën e Prishtinës dhe e cila ka ngecë për ndërtimin e rafteve dhe përgatitjen e rafteve për këta fëmijë që çanta e fëmijëve shkollor të reduktohet për fatin e keq të fëmijëve tanë çanta shkollore e fëmijëve të cikleve të ulëta po shkon për çdo vit duke u rënduar dhe kjo paraqet një problem serioz, për shkaqet, arsyet dhe mënyrën se si duhet të rregullohet kjo bërë mjaft diskutime në të kaluarën. Prandaj, nuk do të zgjasë, mirëpo dua të tërheq vërejtjen të gjithë atyre të cilët janë duke u marrë me këtë punë në aspektin zyrtar në Ministrinë e Arsimit që nuk janë duke e bërë punën e duhur. Është dashur që tani pas kaq vitesh ministri i Arsimit vetëm të pranojë si fakt, por të mos japë zgjidhjen. Ne kërkojmë që ky problem të zgjidhet për interesin dhe shëndetin e fëmijëve tanë.

Çështja e dytë është me Ministrinë e Shëndetësisë, është një problematikë që vërtet na shqetëson të gjithëve. Do të doja që në atë deklarinimin jashtë rendit të ditës ministri i Shëndetësisë të jetë këtu dhe të na informoj për cilën hap të mirë ka bërë kjo ministri prej se ka fillua punën. Ajo çka kemi pa këto ditë është një degradim i punës në Ministrinë e Shëndetësisë në veçanti me zëvendësimin e profesionistëve shëndetësorë, doktorëve, profesorë të shkencave në komisionet dhe bordet e ministrisë dhe zëvendësimin e tyre me kuadro gjysmë profesionale me specializantë dhe specialistë nga Gjilani. Ministri i Shëndetësisë duhet ta kuptoj që nuk është ministër i Gjilanit, por është ministër i Shëndetësisë së Kosovës dhe këtu do të duhej të japë një llogari në deklarinimet jashtë rendit të ditës.

Dhe, krejt në fund, jo për nga rëndësia, çështja e tretë ka të bëjë me një ngecje të punëve rreth projekteve në komunën e Mitrovicës, si ato në aspektet infrastrukturorë sportiv, por edhe të infrastrukturës tjetër.

Sheshi i Mitrovicës tani e disa vite për shkak të neglizhencës, punëve atje është bërë i padurueshëm jo vetëm për qytetarët por edhe për bizneset të cilat janë dëmtuar në mënyrë të rëndë për shkak se ai ambient është bërë një punishte në vazhdimësi dhe në vazhdimësi po shkohet duke u shtyrë afatet e investimeve dhe përfundimet e atyre investimeve atje. Prandaj, kërkoj një përgjegjësi nga kryetari i Komunës së Mitrovicës zoti Bahtiri që të jetë në nivelin e detyrës, mos del vetëm sa për tu reklamuar në televizion në shesh por qytetarët e Mitrovicës presin që sheshi dhe projektet tjera infrastrukturore në Mitrovicë dhe ato sportive të përfundojnë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që vërtet edhe gjatë këtij sesi do të merremi me probleme të cilat janë kryekëput të qytetarëve e më tepër edhe pse jemi pjesë e politikës vërtetë na duhet që këto probleme t'i adresojmë në mënyrë të drejtë. Kërkoj një angazhim të theksuar të dy ministrive të cilat janë përgjegjëse në këtë rast të Ministrisë së Arsimit dhe Shëndetësisë që të jenë në nivelin e tyre edhe përgjegjësi, të cilat i kanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë po ju them, deklarohuni kush flet në emër të grupit. Armend Zemaj, a flet ti a për grupin.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Në emër personal do ta ngre një çështje, e cila është shndërruar në fenomen tash edhe është shqetësuese, jo vetëm për ne si përfaqësues të qytetarëve, por edhe për qytetarët që ka të bëjë me fenomenin e fajdeve në Republikën e Kosovës, e cila qoftë në grupet e organizuara, qoftë në atë individuale është një problem i cili akoma nuk ka marrë goditje as nga Policia, më së paku nga Prokuroria dhe gjykatat e vendit.

Këto janë shndërruar në biznes të pistë për përfitues, për fajdexhinj dhe përkrahës të tyre, zhvatje për qytetarët e varfër dhe zhvillim edhe të krimit të organizuar në vend. Sidomos kemi pasur edhe vrasje, dhunime, shkatërrime por edhe ikje të qytetarëve jashtë vendit nga ky fenomen i cili faktikisht nëse i marrim ato çka janë perceptime të qytetarëve, është e mbështetur edhe nga organet e sigurisë dhe të cilat e kryejnë një punë të mirë për t'ia ndihmuar, qoftë në aspektin e përcjelljes, qoftë në aspektin e dhënies dhe, mbi të gjitha, edhe të ruajtjes së tyre.

Andaj, e ftoj Policinë e Kosovës në këtë rast ministrin e Punëve të Brendshme që jo vetëm në aspektin e operacioneve lokale, por në një operacion në nivel të vendit të godas në mënyrë ligjore të gjithë ata të cilët po e zhvatën njerëz, bizneset, por mbi të gjitha e kanë një mbështetje të fortë politike dhe atë e kanë deklarua dhe është deklarua shpeshherë qoftë nga njerëz qoftë nga individ po mbi të gjitha nga shoqëria civile dhe organizatat, të cilat e monitorojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin në vend.

Andaj, unë po shpresoj dhe besoj që kjo çështje do të ngrihet në nivel më serioz, jo vetëm në aspektin lokal siç është tash po dëgjojmë që ka intervenime në një qytet të caktuar vetëm kur ndodhë rasti në komunën e Prizrenit, por fajdexhinj dhe fenomeni i fajdesë ka lulëzuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Unë po flas për pjesën për pjesën ku jetoj, sidomos në komunat Deçan, Pejë, Junik, Gjakovë, jo vetëm që kanë dëmtuar familje të caktuara, jo vetëm që kanë pësua me jetë njerëzit po sot bizneset nuk mund ta ushtrojnë një veprimtari të lirë nga fajdexhinj, të cilët operojnë dhe njëherësh deklarojnë se kanë edhe mbështetje edhe nga organet e sigurisë, por edhe nga politika. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk Konjufca, shef i Grupit Parlamentar “Vetëvendosjes”, në emër të grupit.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të nderuar të Republikës,

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Prej kur e ka nënshkruar marrëveshjen e tradhtisë kombëtare për ‘Zajednicën’, kryepolici i Kosovës Isa Mustafa ka arrestuar 51 aktivist të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Shumica prej këtyre janë arrestuar kryesisht duke i bërë dy aktivitete ose duke shkruar parulla kundër ‘Zajednicës’, ose duke shpërndarë fletushka që shpjegojnë dëmin e kësaj krijese të Beogradit.

Më 25 gusht u arrestuan tre aktivistë vetëm pse deshën që në oborrin e kryeministrin ta vendosnin parullën “Shiti pronat tua, e jo të Kosovës!”. Prej atij momenti, Isa Mustafa ka folur shumë me qindra herë për shenjtërinë e pronës së tij private, por asnjëherë për vlerën e pronës shtetërore që ai po e shet.

Më 26 gusht u arrestuan tre aktivistë duke ecur rrugës dhe të cilët i dërguan në Departamentin e Krimeve Kibernetike, vetëm pse njëri prej tyre kishte me vete laptop. Dy ditë pas u arrestuan dy aktivistë njëri në Prishtinë e tjetri i Istog. Kurse më 29 gusht, tre të tjerë u arrestuan po ashtu në Istog vetëm pse po shkruanin parulla kundër ‘Zajednicës’.

Më 1 shtator u arrestuan katër aktivistë në Ferizaj, kurse të nesërmen u arrestua një aktivist në shtëpinë e tij në Prishtinë dhe dy të tjerë vetëm pse policia u gjeti fletushka në veturë.

Më 4 shtator u arrestuan katër aktivistë në Vushtri duke shkruar parulla, kurse më 7 shtator u arrestuan katër aktivistë duke shpërndarë fletushka përpara objektit të Qeverisë të ish-Rilindja.

Më 8 shtator u arrestua një tjetër aktivist, kurse një ditë pas u arrestuan dy aktivistë për shkak se hollën ngjyrë në veturën e kryeministrit dhe më 11 shtator 15 aktivistë u arrestuan sepse ua shfryngomat e veturave Qeverisë që na e solli ‘Zajednicën’.

Prej 25 gushtit nuk pati veç arrestime por edhe dhunë të pandalshme dhe ndërhyrje brutale me urdhra të qartë politikë. Çka na tregon ky instrumentalizim i paparë i Policisë së Kosovës? Kjo tregon që Qeveria e Kosovës e ka kuptuar shumë mirë se çka ka nënshkruar në Bruksel.

Ajo e ka nënshkruar bosnjëzimin e Kosovës, prandaj tash po fshihet pas policisë dhe po e përdorë policinë e shtetit tonë për t’i mbrojtur vendimet e veta kundër Republikës.

Isa Mustafa erdhi në pushtet duke thënë se për marrëveshjet me Serbinë duhet referendum gjithëpopullor, sot ai na e sjell një marrëveshje që e cungon shtetin tonë dhe i mobilizon të gjitha institucionet e sigurisë për të arrestuar opozitën.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë çështjen që mendova me ngrit për këtë seancë ose fillimin e Sesionit vjeshtor pak a shumë e konsumoi Armendi, por sido që të jetë unë do të vazhdoj aty ku e la Armendi.

Kosova vazhdon të jetë në gjendje të papranueshme për jetë normale të qytetarëve, veçanërisht me fenomenin tashmë, i cili ka lulëzuar dhe ka kulmuar në Prizren, haraçi dhe fajdetë.

Jeni dëshmitarë se në Prizren shumë shpesh ndodh që qytetarët të përfundojnë në mënyrë më tragjike të mundshme, edhe skena të kaubojve, siç ka ndodhur ditëve të fundit në Prizren janë më shumë se të papranueshme dhe unë po mendoj për çdo qytetar, veçanërisht deputetë, ministra, ministrat përgjegjës në këtë rast, duhet të jenë të shqetësuar me atë çfarë po ndodh në Prizren, por edhe në Kosovë.

Unë desha të tërheq dy paralele për ta thirrur ndërgjegjen e dy ministrave, komandanti tash i suspenduar, një ditë para se të ndodhë një vrasje del publikisht tha se me qindra lëndë, vepra penale ka njerëz të caktuar dhe lirohen dhe nesër ndodh një vrasje që ka mund të jetë hala më tragjike se që ka ndodhur.

Një ditë pas vrasjes, prokurori i Prizrenit del thotë se ky fenomen është në rritje e sipër, që lë me nënkuptua se kjo storie rishtuese do të vazhdojë në Prizren dhe në këtë rast unë e ftoj ministrin e Drejtësisë, por edhe ministrin e Punëve të Brendshme, ku gjendet situata në Prizren dhe në Kosovë me këto fenomene, siç e thashë në fillim shqetësuese. Edhe në këtë rast si deputet që vij nga qyteti i Prizrenit edhe në emër të qytetarëve të Prizrenit kisha ftuar urgjent institucionet e shtetit, gjithë mekanizmat që seriozisht ta marrin këtë çështje dhe të merren me këtë fenomen i cili 15 vjet pas luftës është evident dhe është në lulëzim e sipër dhe në rast se nuk ndërmerret urgjent diçka në këtë drejtim besoj që dikur do të jetë vonë. Shenjat domethënë nga vetë zyrtarët lokal tregojnë se do të jetë vonë.

Çështjen tjetër që mendova ta trajtoj publikisht është një çështje e cila është diskutuar veçanërisht në fillim të këtij viti në janar dhe shkurt çështja e orëve digjitale ose matësve të njësorëve elektrikë, por edhe matësve tjerë.

Me që nuk është ministria këtu, unë kisha kërkuar publikisht ministres së Tregtisë edhe një herë të merret seriozisht me Institutin Meteorologjik sepse llogarisë dhe qëndroj në atë se marrja e Institutit Meteorologjik në kuadër të kësaj ministrie është konflikt interesi dhe vetë fakti që ministria para se me dalë me bë inspektimin në pompat e benzinës paralajmëron një komunikatë kjo i bie që, këqyrni ju që jeni tu vidhni nesër mos vidhni se ne kemi me dalë në kontroll.

Mendoj që Instituti Meteorologjik duhet të tërhiqet nga ministria dhe të krijohet në agjenci të pavarur edhe për faktin sepse është debatua dhe kanë dalë edhe deputetë tjerë këtu Sadria në rast se nuk gaboj me fakte se një pjesë e orëve digjitale janë duke vjedh qytetarin dhe këtë e ka konstatua edhe një analizë që është bërë në Holandë. Ndërsa në anën tjetër vazhdojnë ato orët ta vjedhin qytetarin dhe askush nuk merret me to. Thjesht, unë edhe në këtë rast kisha kërkuar nga ministri, nga organet përgjegjëse që thjesht të stopohet vjedhja në mënyrë institucionale kushtimisht po them që po i bëhet qytetarit lidhur me matjet, jo veç me orët digjitale, por edhe matësit tjerë dhe që duhet me qenë nën kontrollin e Institutit Meteorologjik.

Çështja të cilin Ramushi e përmendi, unë para seancës me Agimin, pasi është edhe kryetar i Komisionit rastësisht e patëm një temë ta pasur tepër lëshime, është momenti i fundit Komisioni Qeveritar për Verifikimin e Vlerave të Luftës, të njerëzve të cilët kanë qenë aktivë në luftë sipas kategorive t'i bëjë përmirësimet të cilët janë lëshuar dhe kanë ngritë shqetësime të arsyeshme të ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me që është ky proces në përfundim, unë po mendoj se edhe kryetari i Komisionit dhe anëtarët tjerë të Komisionit e kanë këtë mundësi pasi ka pasur reagime dhe debate publike lidhur edhe me mashtruesit me i marrë të gjitha parasysh dhe me përfundua, por edhe një herë dua ta potencoj diçka që e kam thënë dje publikisht - procesi i verifikimit të veteranëve të luftës.

KRYESUESI: Zafir, të ka kaluar koha. Zafir, e kalove pesëminutëshin! Mos u merr me të tjerët çfarë kanë thënë. Edhe gjysmë minute e ke!

ZAFIR BERISHA: Kryetarin e komisionit në këtë rast edhe një herë po e ftoj, që të merret seriozisht dhe ato që janë demantuar publikisht të përmirësohen mundësisht në javën e fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Zafir! Zotëri Qerim Bajrami, në emër të Grupit “6+”, e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani ministri,

Želim nam hajrli početak jesenjeg zasedanja Parlamenta Republike Kosova.

Dozvolite mi da sa svima vama ovde i sa građanima Kosova podelim jednu našu veliku muku, dakle svih nas nevećinskih zajednica i Bošnjaka, i Turaka i Roma i Aškalija i Egipćana. Naime, radi se da je danas 17 septembar i zadnji rok za upis studenata u drugom roku na Prištinskom Univerzitetu, na Univerzitetu u Prištini.

Nažalost, u ovom drugom roku nije bio objavljen konkurs za studente iz nevećinskih zajednica. Mi smo prije dvije nedelje ovo uočili i bili smo na razgovor kod našeg uvaženog ministra Arsima Bajrama koji je trenutno u Americi službeno, obavlja tamo dobre poslove i evo dvije nedelje nažalost, niti MONT, dakle niti Ministarstvo obrazovanja, niti Rektorat i rektor Univerziteta u Prištini nisu preduzeli ništa da se taj konkurs obnovi i da potencijalni studenti, koji čekaju i danas i mene ovdje i sve nas gledaju ili očekuju od nas neko rešenje.

Prema tome, uvaženi predsedavajući, i gospodo poslanici, uzimajući u obzir da je naš premijer juče na Vladi Kosova dao jedno obećanje javno, koje je preneto i medijima na albanskom i na bosanskom jeziku a koji je rekao da nam ovo ne treba, jer se radi o jednom ograničenom broju studenata i radi se o nekom pozitivnom rešenju, koje treba da i Rektorat i Ministarstvo Obrazovanja što prije razmotriti.

Ja pozivam ovde prisutne ministre da prenesu premijeru ovaj moj apel da on još jednom interveniše kod Ministarstva Obrazovanja a da Ministarstvo Obrazovanja odmah stupi u kontakt sa rektorom i Rektoratom i da se ova nepravda, da ne kažem još jednu dobru riječ, koja inače slijedi za ovo, što prije ispravi, jer u njihovoj odluci dakle jasno stoji od objave konkursa iz jula mjeseca, da će na svim fakultetima na kojima budu ostala nepopunjena mjesta biti ponovno objavljen konkurs. I oni su taj konkurs obnovili za nevećinske zajednice, što je dobro, i za sve povlašćene kategorije iz Makedonije, Preševske Doline, Crne Gore i Albanije.

Konkurs nije objavljen samo za potencijalne studente iz nevećinskih zajednica, što je ogroman propust rektorata i mi odavde apelujemo da se on što prije ispravi, dakle u toku dana. Radi se o jednom veoma važnom pitanju, jer moram i ovdje da ponovim kao i mnogo puta do sada, nažalost neko zna a neko i ne zna, a nekoga sve ovo i ne interesuje. Međutim, i Bošnjaci Kosova i Turci Kosova a i Romi, Aškalije i Egipćani su u obrazovnom sistemu Republike Kosova. Prihvatili su i Bošnjaci i Turci da studiraju i na albanskom jeziku, što je sve ovo dobro i što sve vodi ka dobrom.

Prema tome, nemoj zahvaljujući nekome tamo, koji misli da mu je babovina i da može radi šta god oće, dobijamo sve ove negativne pojave, nažalost i ove, i prošle godine. Ne želimo mi iz nevećinskih zajednica da budemo ... šteta odnosima u Rektoratu i odnosima rektora i Rektorata, ili Rektorata sa Ministarstvom obrazovanja.

Apelujemo još jednom da se ovo u toku dana ispravi, u protivnom ćemo tražiti i zahtevamo da se primeni mehanizam trećeg upisnog roka, koji je sasvim moguć, jer su ta mesta namenjena nama. Mi smo građani Kosova, a to je javni glavni Univerzitet na Kosovu i naša mesta sleduju samim tim što je doneta odluka da preko 300 mesta sleduje kao rezervisana za nevećinske zajednice. Zahvaljujem!

KRYSUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht ju uroj një sezon të mbarë vjeshtor, unë kam një çështje sociale.

Gjatë periudhës së verës prezenca e bashkatdhetarëve dhe komunikimi me ta nxori edhe disa të dhëna të reja mbi disa çështje të veçanta, përfshirë edhe çështjen e adaptimit apo siç e kemi në fjalor zyrtar “ birësimin e fëmijëve nga Kosova” për personat, të cilët nuk jetojnë në Kosovë. Duke i ditur rrethanat ekonomike dhe sociale në vend e njohim faktin se deri ku shkojnë mundësitë tona për të menaxhuar suksesshëm me shtëpitë në të cilat strehohen dhe rriten një pjesë e këtyre fëmijëve, të cilët braktisen nga prindërit për arsye të ndryshme.

Nga pas lufta e deri sot shumë nga këto qendra kanë ekzistuar falë donacioneve të organizatave ndërkombëtare dhe njerëzve vullnet mirë. Çështja ime sot ka të bëjë me procedurat e birësimit jashtë Kosovës, të cilat sipas disa familjeve të investiguara zgjasin nga disa muaj e deri në 3 vjet. Dhe ne kemi një udhëzim administrativ i cili parasheh që kriteri për birësimin e fëmijëve jashtë Kosovës, pra pikërisht neni 179 shtetësia adaptues mund të jetë vetëm qytetari i Kosovës, përjashtimisht shtetasi banori i huaj mund të jetë palë adaptuese nëse fëmija nuk mund të adaptohet ose të birësohet në Kosovë ose ekzistojnë arsye të bazuara për veprimin e tillë nëse fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar. Pra, i bie që një familje që jeton bashkatdhetarët tanë pra, dëshirojnë të marrin një fëmijë ajo mund të jetë vetëm nëse nuk është mirë me shëndet apo i sëmurë që ka mundësi të dal jashtë vendit dhe të birësohet nga një familje.

Kuvendi dhe ne si deputetë, të gjitha ligjet të cilat i kemi shqyrtuar qoftë projektligje, qoftë ato të amendamentuara sigurisht që janë të bazuara mbi konventat ndërkombëtare, mirëpo në rastin e ndjeshëm që ne t’i ofrojmë një familje këtyre fëmijëve që rriten pa dashurinë prindërore duke u munduar të jemi shumë të kujdesshëm “me procedura” të stërzgjatura ia humbim mundësinë dhe i humbim shumë mundësi që këta fëmijë të kenë një familje të mundshme. Pra, nëse një familje pret prej 3 muaj deri në 3 vjet që të adaptohet ai fëmijë e kalon kohën dhe moshën ku mund të ambientohet me një familje të re, me një familje të veten të cilën nuk e ka aktualisht.

Fëmijët që presin për tu birësuar përmes këtyre procedurave përfitojnë sigurinë maksimale me ligjet tona, pra nga ana e zyrtarëve tanë nuk kemi qoftë deri sot fatbardhësisht asnjë rast që ka devijuar nga programi kombëtar yni për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ne si deputetë kemi mundësinë që të shikojmë edhe njëherë edhe Ligjin për familjen, edhe aktet tjera sekondare që dalin nga ky ligj dhe njerëzve dhe bashkëkombësve tanë që kanë një vullnet të tillë, të mirë të birësojnë fëmijët që rriten pa prindër në qendrat e strehimit në Kosovë të trajtohen pra më lehtë dhe më ndjeshëm. Këto raste nuk është që nuk trajtohen nga çështja humane, apo neve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Etem Arifi.

ETEM ARIFI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Dola këtu ta ngre një shqetësim të qytetarëve të shtresës më të ultë të shtetit tonë.

Janë disa qytetarë, janë disa njerëz që nuk kanë asnjë përkujdesje nga shteti që të vetmin burim e kanë nga shitja e gjësendeve të vjetra veshmbathjes që i falen ndoshta nga dikush në tregjet e hapura. Nuk e kam fjalën për ata njerëz shitës ambulant që dalin nëpër rrugë, por nëpër tregje të hapura. Unë do ta marr si shembull tregun në Ferizaj, janë penguar njerëz që t'i shesin ato gjësende, ato veshmbathje të vjetra dhe prej tyre është kërkuar tatim, është kërkuar arkë fiskale që nuk shans, nuk ka teori për ata njerëz që të sigurojnë arkën fiskale ose tatim.

Për shumë tregtarë është ndoshta e tepërt, e për ata tregtarë për ta kërkuar edhe taksën e atij tregu, e jo ta kërkojnë një tatim ose sidomos arkën fiskale, ju lutem. Ku ka në botë që një njeri del e siguron kafshatën e gojës që veshmbathja ose pa marrë parasysh gjësende të vjetra, ju kanë fal nga dikush ose i ka gjetur në kontejner dhe del i pastron dhe i shet në treg atje për ta fituar një kafshatë të gojës për familje, dhe inspektori i thotë “ku i ke marrë këto sende” ose “a e ke arkën fiskale”, ose “a ke paguar tatim”. Ju lutem, kurrkund në botë nuk ndodh kështu.

Tjetra, unë ju kisha lutur edhe Kabinetit qeveritar, edhe inspektorëve të komunës, kryetarëve të komunave, që këta njerëz të mos i prekin sepse janë shtresa më e ultë qytetarëve tonë të Kosovës. Më e varfër është, realisht më e varfër sepse ata njerëz dalin nëpër, kur them kanë dal dhe i kanë gjetur ndoshta nëpër kontejnerë, i kanë tubuar nëpër kontinjera dhe i kanë marrë i kanë pastruar edhe del në treg për t'i shitur, për ta fituar kafshatën e gojës realisht është shtresa më e varfër në Kosovë dhe prej tyre të kërkojnë këto, është absurde. Unë për vete nuk e kam, nuk po mundem ta sjell në kokë si mundet t'i pengojë, plus asaj merret në pyetje nga inspektorët se ku janë marrë ato sende.

Veshmbathja që dikush ia ka falur që nuk i vesh, dikush ai del dhe i shet, nuk ka nevojë atij arkë fiskale, sidomos arka fiskale ku ka logjik kjo. Unë kërkoj, apeloj te Qeveria edhe te qeveritë komunale që të mos pengohen këta njerëz, këta njerëz duhet të stimulohen, duhet të ndihmohen në njëfarë forme përderisa nuk jemi në gjendje t'u ndihmojmë si shtet, si institucione që t'ua sigurojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! 30 minutat e parapara për deklarata jashtë rendit të ditës janë kryer. Kalojmë në pyetjet parlamentare.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Në këtë seancë janë parashtruar 28 pyetje parlamentare. Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Valon Murati.

Deputetja s'është këtu? Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin Skënder Hyseni. S'është deputeti. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. S'është Visari, s'është Blerandi.

Deputeti Visar Ymeri, përsëri pyetje për ministrin Stavileci, nuk janë asnjëri. Deputetja Puhie Demaku, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. A do ta bësh pyetjen? Mirë, shtyhet.

Deputetja Puhie Demaku, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçin. Prapë e shtyn pyetjen. Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Zonja deputete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ishalla veç janë mirë, nuk ju ka ndodh diçka këtyre ministrave. Unë e kam bartur njëherë pyetjen, më duket që në bazë të Rregullores së Kuvendit kanë drejt mi bartë edhe njëherë i kisha dy pyetje të cilat i kam bërë, më 23 korrik të këtij viti, por fatmirësisht edhe fatkeqësisht njëkohësisht nuk e kanë humb ende aktualitetin, kështu që po i barti për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Mirë! Faleminderit! Ganimete Musliu dy herë, prapë për Skënder Hysenin. Deputetja Xhevahire Izmaqi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. S'është Xhevahirja. Deputetja Albulena Haxhiu pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Nuk ka pyetje, nuk bëhet sepse s'është ministri. E qartë, zonjë e qartë s'po dëshiron ta bësh pyetjen, u mor vesh kjo punë.

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministren Hykmete Bajrami. Zonja deputete, deklaro çka po do?! Deputetja Shqipe Pantina, regjia jepja fjalën le të deklarohej çfarë po do!

SHQIPE PANTINA: Ministria s'është këtu, s'ka kush të përgjigjet.

KRYESUESI: Ashtu, faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Hyseni, jepjani fjalën deputetes.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Është një problem shqetësues që edhe më herët e kam ngritur, ndërsa ministri Hyseni nuk e ka marrë mundin as të përgjigjet me shkrim, por as me gojë.

Çështja është heqja dorë nga shtetësia e Kosovës e cila ka shënuar shifra alarmante në pesë vjetët e fundit. Mbi 32 mijë qytetarë të Kosovës kanë hequr dorë nga nënshtetësia kosovare vetëm nga viti 2009, për të zgjedhur një nga shtetet e Bashkimit Evropian që nuk e lejojnë dyshtetësinë, kampion në zbrazjen e Kosovës është Gjermania. Në këtë ritëm të heqjes dorë nga nënshtetësia brenda 10 vjetëve Kosova do të ketë 100 mijë banorë më pak. Protagonistët të këtyre veprimeve thonë se edhe pse me zemër të thyer këtë po e bëjnë për perspektivën e familjes dhe perspektivën e fëmijëve të vetë. Ndërkohë që analistët e vlerësojnë që kjo situatë është baras me tragjedi kombëtare.

Për 5 vjet 32 mijë qytetarë më pak, ndërsa për 5 vjetët e ardhshme do t'i kemi 100 mijë qytetarë më pak. Pyetja ka qenë: se cilat veprime do t'i merr ministri Hyseni në këtë drejtim, a do të llobojë me shtetet anëtare të BE-së, të cilat nuk e lejojnë dy shtetësinë dhe a do t'u mundësohet qytetarëve tanë sikurse edhe qytetarëve të shteteve tjera që të kenë dy shtetësinë. Por, është e pakuptimtë që ministrat dhe Qeveria nuk është marrë me këtë lëmi, sepse po shihet se kah po e qojnë Kosovën. Po e zbrazin Kosovën dhe sikur me veprimet e fundit që ka marrë kryeministri Mustafa, lidhur me demarkacionin edhe me asociacionin e komunave serbe.

KRYESUESI: Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Urdhëro, deputete!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në seancën e mbajtur, më 22 dhjetor të vitit 2014, ju ministër deklaruat se sigurimet shëndetësore do të fillojnë të implementohen në janar të vitit 2015.

Pyetja ime për ju është: Kur do të fillojë implementimi i sigurimeve shëndetësore?

KRYESUESI: Atëherë, kush përgjigjet? Përgjigjet ministri i Shëndetësisë. Urdhëro, atëherë përgjigju ti, pra!

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

E nderuara deputete, unë e kam parë pyetjen e juaj qëndroj në at deklaram që kam thënë atëherë kur është aprovuar buxheti për vitin 2015, mjetet kanë qenë të parashikuara në vitin e buxhetit 2015, por ministri i Shëndetësisë ka vërejtur që nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për të filluar me sigurimet shëndetësore.

Prandaj, pyetjen për të treguar cilat përgatitje është dashur të bëhen, cilat po i bën tash ministri i Shëndetësisë, dhe kur ai e parasheh afatin kohor kur i bën përgatitje ministria, do u jap ministri i Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Po, para se të përgjigjet ministri edhe njëherë pyetjen për ministrin e Financave i cili vetë ka deklaruar, prandaj ministër mos u ngutni po bëhuni të sinqertë një herë, tregojuni popullit dhe mos merrni shpejtësi për të thënë diçka që nuk mundeni që ta realizoni. Kjo po shihet, jeni kah i bëni dëm Kosovës dhe dëmet janë shumë të mëdha.

Prandaj, pse po nguteni kur asnjëherë nuk jeni të përgatitur dhe po i mashtroni qytetarët. Ju vetë keni deklaruar që nga 1 janari i vitit 2015, e kam shënuar në fletoren time personale. Mund ministri i Shëndetësisë, në qoftë se ka diçka t'u thotë qytetarëve.

KRYESUESI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete, ne kemi çka t'ju themi qytetarëve, sepse gjatë kësaj kohe kemi punuar mjaftë shumë në funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, punë e cila është dashur të bëhet edhe është duke u bërë me intensitetin më të madh të shtuar.

Është në koordinim me Qeverinë, respektivisht në biseda të shpeshta intensive me ministrin e Financave ne kemi arrit që ta aprovojmë Rregulloren e funksionalizimit për funksionalizimin e AFSH-së, Rregullore kjo që nuk ka qenë as në fillim, as në letër.

Bazuar në Ligjin për sigurime shëndetësore është themeluar Këshilli përgatitor për themelimin e fondit të sigurimeve shëndetësore i cili në përbërjen e vetë ka përfaqësues edhe të Ministrisë së Financave, edhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetarë të odave, kryesues i një bordi të shërbimit spitalor, përfaqësues të drejtorëve të shëndetit primar, përfaqësues të Shoqatës së pacientëve dhe përfaqësues i AFSH-së.

Pas kësaj është formuar grupi për aprovimin e Rregullores së punës së këtij këshilli dhe kjo rregullore është sjellë. Në këtë kohë janë shtyrë përpara shumë procese të filluara dhe të pafilluara në përgatitjen e udhëzimeve administrative, siç është udhëzimi shumë domethënës për mbledhjen e premiumeve që është në fazën finale, pastaj është udhëzimi administrativ për sigurimin e detyruar shëndetësor dhe janë duke u përgatitur një varg i udhëzimeve administrative dhe dokumenteve operative, të cilat janë të nevojshme që të fillojë siguri shëndetësor.

Gjithashtu, është instaluar softueri i sistemit të informimit të fondi të sigurimit shëndetësor brenda sistemit të ... shëndetësor që është duke u testuar në këtë fazë në pilot projektin që po shkon në 64 institucione shëndetësore.

Ndërsa, vendimin final për fillimin formal të mbledhjes së premiumeve dhe më vonë edhe të kontraktimit të shërbimeve do ta bëjmë në momentet kur të përfundojnë konsultimet me Qeverinë komplet, me odat ekonomike, me Këshillin ekonomik social, sindikatat dhe partnerët e tjerë relevant në këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Taksat e qytetarëve në të shumtën e rasteve po përfundojnë të abuzuara, për shkak të prioriteteve që nuk po përcaktohen konform interesave të qytetarëve, por me anime klienteliste.

Pyetja ime për ministrin është: në bazë të cilave kriteret keni vendosur për renovimin e spitalit në Komunën e Vushtrrisë?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

E nderuara deputete,

Më vjen keq që ne po humbim kohë këtu, sepse i keni informacionet jo të sakta.

Renovimi i spitalit të Vushtrrisë është komplet donacion, edhe atë nga donatori i cili ka pasur vullnetin ta ndërtojë këtë spital në fillim edhe kanë ardhur e kanë vlerësuar në çfarë gjendje është dhe kanë vendosur ta rinovojnë nga fillimi dhe ta bëjnë një nga spitalet më të mira në Kosovë.

Donatori është Emiratet e Bashkuara Arabe, ata të cilët janë edhe donatorët e spitalit tashmë në fazën finale të përfundimit të projektit për Spitalin e Pediatrisë në Prishtinë. Prandaj, nuk janë fonde publike.

KRYESUESI: Deputete, pyetje shtesë? Deputetja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Do të thotë nëse janë donacione sipas jush ministër duhet të shkojnë edhe aty ku nuk është interes i qytetarëve, unë nuk predikoj që nuk ka nevojë ndoshta për rinovim, por ankesat e qytetarëve vazhdimisht që ai spital është përruar në vitin 2004-2005 dhe janë dhënë miliona euro, dhe që nuk ka qenë e nevojshme, por mbi të gjitha janë edhe shumë e shumë shqetësime të tjera dhe sa i përket inventarit që është dhënë kompanisë për riciklim, inventari i cili kishte mundur të qitet në ankand dhe të merren nga shitja e atyre pajisjeve të shkojnë në buxhetin e Kosovës dhe të tentohet që të mbushet buxheti jo në të kundërtën të bëhet diçka, se ka shumë prioritete tjera edhe kjo komunë edhe shumë komuna të tjera.

Ka edhe spitale të tjera që kanë nevojë shumë më shumë dhe nuk do të thotë pse është donacion t'i humbni ato të holla apo t'i jepni sa për përfitime politike dhe për njerëz të juaj që thjeshtë po i favorizoni jo me interesa, por në dëm të qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Spitali i Vushtrrisë mban emrin e mbretit "Sheik Zaid" dhe familja e tij kur e kanë parë në çfarë gjendje ka qenë kanë vendosur që ta rinovojnë dhe të kthehet në gjendje normale të një spitali.

Ata kanë qenë që kanë vendosur që Spitali i Vushtrrisë të rinovohet edhe ata kanë vendosur, kanë shpreh dëshirë se ne mund ta rinovojmë këtë spital dhe në të tjera spitale nuk kanë pas vullnet që të investojnë dhe investimet janë bërë aty. Vullneti tjetër është se e përmenda spitalin prej 22 milionë edhe shpresojmë që do të kemi edhe donacione të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Zharku.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Ministri nuk është këtu, por me sa e di e kam edhe një pyetje shtesë për ministrin e Shëndetësisë.

KRYESUESI: Po vjen ajo, por çka po thua për të parën?

BLERTA DELIU-KODRA: Në rregull, për të parën nuk është ministri, s'po e bëj pyetjen.

KRYESUESI: Atëherë, deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Pyetja ime është për braktisjen e vendit të punës nga një numër i anesteziologëve. E kemi pas do të thotë muajin e fundit tre anesteziolog, të cilët e kanë braktisë sektorin publik dhe kanë kaluar në vende të tjera të punës. Cila është strategjia kuadrore e Ministrisë së Shëndetësisë për të parandaluar këtë dukuri, sepse kjo dukuri tashmë po bëhet shumë e shpeshtë në sektorin publik.

KRYESUESI: Ministri Rrahmani e ka fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit deputete Deliu për pyetjen,

Është një shqetësim i kahershëm që profesionistë shëndetësor dhe ata deficitar, siç janë profesionistët, specialistët e anesteziologjisë janë në numër të vogël në institucionet tona publike, por në përgjithësi në Kosovë dhe kërkesa për ta është e madhe. Arsyeja pse ata i lëshojnë institucionet publike është fitimi më i madh, respektivisht pagesa më e madhe në sektorin privat.

Ne çka kemi bërë, në fillim e kemi marrë një vendim që kemi ndërprerë ndërrimin e specializimeve kush, kujt iu ka tek me dal edhe ai vendim është në fuqi dhe nuk kemi lejuar që tash e tutje specializantët që iu kanë dedikuar një specializimi ose kanë fituar një specializim ta ndërrojnë. E dyta, jemi duke bërë planifikime, respektivisht marrjen e informatave për të krijuar një databazë të qëndrueshme, reale të nevojave të sektorit të shëndetësisë për profilet e caktuara të specialistëve dhe mbi bazën e tyre ne do të bëjmë listën prioritare për specializime.

Anesteziologjia është e para nga profilet që do të jepen specializime të reja dhe po mundohemi që të krijojmë kushte më të mira të punës nëpër, jo vetëm për anesteziolog edhe për të tjerët, por fatkeqësia është që sa më shumë po i rregullojmë kushtet e punës në sektorin publik atyre po ju shtohet puna dhe ata po kërkojnë më shumë sektorin privat. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Kodra e ka fjalën!

BLERTA DELIU-KODRA: Ministër, nuk janë vetëm anesteziologët do të thotë është edhe një numër i madh i teknikëve të cilët e kanë lëshuar vendin e vet të punës dhe nëse vazhdohet me këtë trend unë mendoj që sektori publik do të jetë vërtetë në rrezik për staf, sepse një pjesë e doktorëve do të thotë po shkojnë në sektorin privat, një pjesë tjetër siç është rasti i anesteziologëve do të thotë edhe ata kanë ndryshuar vendin e tyre të punës, një pjesë tjetër e profesorëve dhe doktorëve eminent të cilët janë para pensionimit dhe këta do të thotë janë kuadro, të cilët ne rrezikojmë që të mos i kemi për shkak të kohës së pensionimit. Po ashtu, një numër i madh i studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit në fushën e shëndetësisë dhe ata me

çfarë arsyetimi dhe me çfarë kriteresh do të kthehen në Kosovë për ta vazhduar punën në sektorin publik.

Dhe nëse vazhdohet me këtë trend, unë mendoj që ne do të mbesin sikurse spitali i Mitrovicës i cili çdo ditë e më tepër po boshatiset prej stafit të vetë shëndetësor dhe po kalojnë në vende të tjera të punës.

KRYESUESI: Ministri s'ë do fjalën. Deputeti Pal Lekaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,
Media, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po shihet që me siguri kryeministri për pyetjen që e kam parashtruar nuk ka kohë apo është duke menduar të japë dorëheqje, ose është duke negociuar për marrëveshjen që i ka bërë dëm Kosovës apo ndoshta e ka ngritur sot flamurin e bardhë. Dhe, mendoj që nuk është serioze, kur një kryeministër i vendit i lë ministrat kështu pa i orientuar drejt dhe mirë për vendin.

Prandaj, pyetja ime do t'i shtrohet kryeministrit kur të jetë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj! Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!
Unë të njëjtën pyetje e kam edhe për ministrin Hyseni edhe për ministrin Kuçi, por meqenëse s'janë këtu, atëherë e lëmë për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Po, e kishe edhe tjetrën, po pra. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë këtu para vetes e kam një dokument të nënshkruar nga Isa Mustafa në cilësinë e kryeministrit të Republikës së Kosovës, ku shkruan, po citoj: "Serbia konsideron se në pajtim me Ligjin vendor dhe ndërkombëtar, përkatësisht Rezolutën 1244, prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Serbisë sipas rregullimit specifik provincial dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë dhe ky dokument ka inicialet e Isa Mustafës.

Pyetja ime është, pavarësisht a është ai sot këtu apo ka ikur e po fshihet skutave, të na japë përgjigje dhe të konfirmojë a qëndron prapa inicialet në këtë marrëveshje dhe të konfirmojë a e ka vënë nënshkrimin e vet në këtë marrëveshje? Kaq kam. Dhe, po e thërras që të vijë edhe një herë në Kuvend dhe të raportojë a është e konfirmuar me inicialet e tij ajo që lexova më parë, do të thotë a ka vënë Isa Mustafa nënshkrim në marrëveshjen ku thuhet, Serbia konsideron se në pajtim me ligjin vendor dhe ndërkombëtar, përkatësisht Rezolutën 1244 prona brenda territorit të

Kosovës është në pronësi të Serbisë sipas rregullimit specifik provincial dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë.

E thërras sot të vijë në këtë Kuvend dhe ta konfirmojë a janë këto initiale të Isa Mustafës në këtë marrëveshje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Më 29 prill Ministria e Shëndetësisë ka mbajtur takimin e parë të Këshillit Profesional për funksionalizimin e shërbimeve të kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, jemi informuar me vendimin tuaj. Më rastin e fillimit të këtij këshilli, i nderuar ministër, patët deklaruar se ky këshill ka për qëllim të funksionalizojë shërbimin e kardiokirurgjisë dhe do të sigurojë shërbim 24 orësh nga kardiokirurgjia për qytetarët e vendit. Kjo është deklarata juaj, prandaj i nderuar ministër, më intereson cilat veprime janë ndërmarrë deri tani brenda këtyre pesë muajve, a është analizuar situata, cili është plani i punës, plani i veprimit dhe të tjera, sa i përket fushës së kardiokirurgjisë. Dhe, më intereson shumë të di, i nderuar ministër, prej fillimit të punës së këtij këshilli është ndërprerë puna në kardiokirurgji, ndërsa ka qenë një ofertë publike e Spitalit “International Medicine Hospital”, që t’u ofrojë për tri ndërhyrje brenda javës stafin e tyre pa pagesë dhe kjo nuk është pranuar dhe nuk është dhënë as përgjigje publike e as me shkrim, ndërsa në të njëjtën kohë janë adresuar qytetarët në “International Medicine Hospital”, që të bëhen ndërhyrjet kardiokirurgjike me paratë e taksapaguesve tanë. Do të thotë, brenda kësaj periudhe kohore keni refuzuar diçka pa pagesë, ndërsa keni dërguar një ditë në spital shërbime me pagesë.

Më intereson të di, i nderuar ministër, pyetja është, kur mund të presin qytetarët e Kosovës që ky shërbim të funksionalizohet 24 orë? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Rrahmani e ka fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari deputet,

Është e vërtetë që në prill është marrë vendimi që në kardiokirurgji mos të veprohet me metodën çfarë është punuar më herët dhe është formuar këshilli, të cilin e cekët.

Ky këshill gjatë tërë kësaj kohe ka punuar shumë intensivisht dhe ka pasur shumë takime, qoftë të brendshme, qoftë edhe me partnerë të mundshëm potencialë për funksionalizimin e kardiokirurgjisë. Natyrisht, që ky këshill ka bërë edhe vlerësimin e të gjitha ofertave, sikur ajo që e cekët, dhe ka vlerësuar që tash nuk jemi në fazën kur ne mund të hyjmë në aventura të tilla të pasigurta.

Qëllimi i këshillit është që deri në fund të shtatorit dhe sipas informatave që kam, në fund të shtatorit kanë me prurje planin dhe opsionin final, se si ne duhet të veprojmë prej fillimit të tetorit. Unë shumë shpresoj dhe besoj, që tash në tavolinë i kemi pasur disa opsione dhe disa oferta dhe

në fillim të tetorit ne do të jemi të gatshëm të fillojmë me kardiokirurgjinë, me personel tonin 24 orë brenda Klinikës së Kardiokirurgjisë, në sektorin publik po flasim. Ato të tjerat, që ne i kemi trajtuar pacientët në nevojë, janë trajtuar duke u bazuar në Udhëzimin administrativ që rregullon trajtimin për jashtë institucioneve publike dhe jemi munduar që ndihmën, ose përkrahjen ta marrin të gjithë qytetarët që me të vërtetë kanë pasur nevojë.

Por, unë tash data nuk dua të jap, sepse s'dua të lidhem për data, por jam shumë i bindur që tetori do të jetë muaji i kardiokirurgjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Bekim Haxhiu, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

BEKIM HAXHIU: Po, i nderuar kryesues.

I nderuar ministër,

Ju data nuk dhatë, dhatë një muaj, ne do të ju mbajmë për fjale. Unë besoj që si ministër i Shëndetësisë ju duhet t'i keni objektivat tuaja, se ku duhet të arrini. Dhe, qytetarët në këtë rast edhe ajo pse është në bazë të Udhëzimit administrativ, prapë është dashur të paguajnë edhe në sektorin privat për këto shpenzime, për shkak se atje nuk mbulohen të gjitha shpenzimet. Mirëpo, çështja është se gjithashtu në këtë sektor të kardiologjia invazive muajin e kaluar është prishur edhe koronografi, më intereson të di nëse jeni informuar për këtë dhe cilat kanë qenë arsyet, për arsye se ai që ka qenë publik nga zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë, që koronografi është prishur për shkak se ka punuar shumë më shumë se sa viteve tjera, nuk është e vërtetë, për arsye se numri i ndërhyrjeve në kardiologjinë invazive është i njëjtë edhe me vitet paraprake 2014 dhe 2013, vetëmve atëherë nuk është prishur koronografi dhe këto pacientë nuk janë adresuar në sektorin privat, shpeshherë për interesa të individëve brenda këtij sektori. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Është e vërtetë që ka pasur herë-herë defekte koronografi dhe është kryesisht nga puna e madhe që është bërë aty dhe nga koha e kaluar është konsumuar, thjesht është përdorur shumë.

Ne me kredinë e butë me Austrinë kemi përpiluar listën për blerjen e aparaturës dhe është proces ky, që do të përfundojë shpresoj deri në fund të vitit. Ne do ta blejmë tash një angiograf, që është më i përparuar dhe që plotëson nevojat e kardiologjisë invazive në nivele më të larta, se sa një koronograf i thjeshtë. Shpresojmë shumë që me fillimin e vitit kjo klinikë do t'i ketë dy koronografë, këtë të vjetrin më pak të përdorshëm dhe atë të riun, që është shumë më modern.

KRYESUESI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Pasi që ministri Bajrami nuk është këtu, pyetjen po e bart për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

REXHEP SELIMI: Pasi që kryeministri është kurrkah, domethënë s'kam kujt t'i bëj pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ISMAJL KURTESHI: Po, faleminderit!

Unë do t'i lexoj pyetjet edhe pse këtij abstenimi masiv të Qeverisë po i vjen era dorëheqje. Ku dihet, ndoshta këta kanë vendosur t'i përgjigjen ftesës së qytetarëve dhe opozitës dhe është takimi i fundit. Do t'i bëj këto pyetje, e të dalë ku të dalë.

Kësaj pyetje mund t'i përgjigjet edhe kryeministri, që vërtet nuk është kurrkah.

Zoti ministër, shumica e dyfishtë që i është njohur padrejtësisht si privilegj minoritetit serb në Kuvendin e Kosovës e që duhet të hiqet si praktikë, sepse po e bllokoi punën e Kuvendit por edhe të proceseve demokratike në përgjithësi, këto ditë u aplikua edhe në Qeverinë e Kosovës.

Ministrat serb në Qeverinë e Kosovës edhe pse pakicë, e stopuan procedimin e Ligjit për arsim të lartë në Kuvendin e Kosovës. Me këtë u pajtuat edhe ministri edhe Qeveria, edhe pse ministrat serb kanë pasur mundësi dhe kohë t'i bëjnë vërejtjet e tyre brenda afatit të paraparë.

Si e arsyeton ministri dhe Qeveria këtë zvarritje të ligjeve me një kërkesë krejt të paarsyeshme. Kjo ka qenë pyetja ime.

KRYESUESI: Dy herë je këtu. Edhe një herë për ministrin Bajrami, nëse ke pyetje.

ISMAJL KURTESHI: Edhe këtë tjetrën do ta lexoj.

Zoti ministër,

Shkolla Fillore Agim Ramadani në fshatin Haxhaj të komunës së Gjilanit është rëndë e dëmtuar nga tërmeti i vitit 2004. Ekspertët e ndërtimtarisë menjëherë pas tërmetit e kanë pas klasifikuar këtë objekt shkollor si të dëmtuar rëndë dhe të papërdorshëm. Me gjithë vlerësimin rreth 100 nxënës vazhdojnë t'i ndjekin mësimet në këtë shkollë edhe pasi që kanë kaluar njëmbëdhjetë vjet nga dëmtimi i shkollës.

Zoti ministër, 151 qytetarë të Haxhajve, nëpërmjet peticionit kërkojnë nga ministria që e drejtoni ju, sa më parë të ndani mjete për ndërtimin e kësaj shkolle, në të cilën rrezikohen çdo ditë nxënësit dhe mësimdhënësit që zhvillojnë mësim në këtë shkollë.

Zoti ministër, duke e vlerësuar të drejtë dhe urgjente kërkesën e qytetarëve të Haxhajve i bashkohem kërkesës së qytetarëve të Haxhajve dhe kërkoj që ndërtimi i kësaj shkolle të planifikohet në Buxhetin e vitit 2016. Peticionin dhe fotografitë e shkollës së Haxhajve i kam përcjellë në kabinetin tuaj më 15 korrik 2015, pasi që mos ndërtimi i shkollës do të ndikojë në migrimin e banorëve të Haxhajve, unë kërkoj që kjo çështje të merret me seriozitetin më të madh.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Qeveria e Kosovës në krye me zotin Mustafa, në mungesë të një koncepti ekonomik për zhvillim, e ndodhur përballë një krize të rëndë financiare po mundohet të sigurojë mjete dhe të mbijetojë duke u vënë konopin në fyt qytetarëve më të varfër të Kosovës, qoftë përmes mashtrimeve si uljen e TVSH-së për bukë dhe rritjen e saj në njëmijë artikuj të tjerë, qoftë përmes heqjes së ndihmave sociale dhe pensioneve invalidore.

Unë sot dua të shtroj çështjen e pensioneve invalidore. Informacionet nga terreni flasin për shumë raste, kur ministria juaj po ua merr të drejtën e pensionit invalidor edhe qytetarëve, që për dekada me radhë kanë gëzuar një të drejtë të tillë. Për ilustrim dua të përmendi rastin e Nexhmi Zenel Osmanit nga Prishtina, i cili që nga moshë 6-vjeçare ka mbetur me aftësi të kufizuara. Prej vitit 1976, pra për katërdhjetë vjet me radhë ka marrë ndihma sociale dhe pension invalidor. Paaftësia e tij për punë është dëshmuar në vitin 1976 përmes librezës së ushtrisë në vitin 1992 dhe '97 me vendim të qendrës sociale më 12 janar 2004 me vendim të sekretariatit për shëndetësi dhe mbrojtjes sociale, më 12 janar 2009 me vendim për pensionin e personave me aftësi të kufizuara, më 17 qershor të vitit 2010 dhe së fundi më 2 shkurt 2014 me raport mjekësor.

Për 40 vjet me radhë ai u pranua si person i paaftë për punë nga institucione të ndryshme dhe në kohëra të ndryshme, për t'u shpallur i aftë për punë pas 40 vjetësh nga Qeveria e Mustafës, dhe atë në moshën 59-vjeçare.

Zoti ministër, a keni ndonjë shpjegim për këtë çështje? Pse atyre që janë të aftë për punë nuk po u gjeni punë, ndërsa ata që janë të paaftë për punë po i ktheni me një vendim qeveritar në treg të punës? Si e shpjegoni që edhe regjimi i aparteidit nuk shkoj aq larg sa Qeveria e zotit Mustafa, sa t'i marrë Nexhmiut dhe shumë rasteve të ngjashme, të drejtën e paaftësisë në punë?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Qeveria Mustafa krahas marrëveshjeve të dëmshme me Serbinë po u jep sovranitet e kompetenca në dëm të territorit tonë dhe në dëm të buxhetit tonë, po në të njëjtën mënyrë po punon edhe me sistemin shëndetësor. Çfarë është pronë publike, pra e të gjithë neve, është e gatshme të sakrifikojë, të dorëzojë, siç është rasti me pronën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Prandaj, zoti ministër i Shëndetësisë, shqetësimet dhe kundërshtimet e qytetarëve, të punëtorëve shëndetësor, të sindikatës së Qendrës Klinike Universitare si dhe neve deputetëve lidhur me spitalin Amerikan kanë qenë dhe janë evidente, sepse kundërligjshëm i keni lejuar punën këtij spitali, duke ndryshuar Udhëzimin Administrativ nr. 08/2007, ku neni 4 e precizon qartë distancën në mes institucioneve publike shëndetësore dhe atyre private e që është 1,5 km.

Këtë çështje e kemi diskutuar edhe në komision për shëndetësi, ku ishit prezent edhe ju dhe përgjigja juaj ishte se kjo është një çështje komplekse dhe se vendimin për hapjen apo mos hapjen e këtij spitali do të merret në Qeveri dhe për këtë do të njoftohemi edhe ne si anëtarë të Komisionit, të cilën gjë ju nuk e keni bërë.

Prandaj, ministër, tani prapë po e parashtroj të njëjtën pyetje, pse u lejua hapja e Spitalit Amerikan në oborrin e Qendrës Klinike Universitare dhe kush e mori një vendim të tillë të kundërligjshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Rrahmani!

MINISTRI IMET RRAHMANI. Faleminderit, kryesues!

E nderuar deputete,

Unë nuk vlerësoj se kemi marrë një vendim të kundërligjshëm, nën një, sepse licencimi i spitalit Amerikan, respektivisht ndërimi i lokacionit është bazuar në ligjin për shëndetësi, neni 25 paragrafi 1, Udhëzimi Administrativ që e citoni ju është ndërruar, është tash Udhëzimi administrativ 06/2015 dhe ka qenë në planin legjislativ të vitit 2014 të punohet, është punuar edhe si draft. Drafti ka qenë në zyrën time, posa e kam marrë postin. Unë edhe njëherë e kam ricikluar nëpër të gjitha zyrat e nevojshme, që ka dashur të vërtetohet ligjshmëria e këtij udhëzimi dhe në atë draft-udhëzim nuk ka ekzistuar distanca 1.5 km. Ne përpos kësaj, jemi konsultuar edhe me shumë partnerë tjerë. I kemi marrë edhe përvojat e shteteve në region dhe shteteve në Evropë, afër dhe larg dhe në asnjë shtet nuk ka distancë, e cila kufizon konkurrencën e lirë.

Ne jemi shtet që kemi lejuar me ligj konkurrencën e lirë edhe në shërbime shëndetësore. Pra, Udhëzimi Administrativ 6/2015 mbi kushtet spitalore, Udhëzimi Administrativ 08/2014 për procedurat për licencim të institucionit shëndetësor dhe Udhëzimi Administrativ 03/2007 aplikimi i rrezeve jonizuese dhe jonizuese janë baza ligjore mbi të cilën e kemi licencuar Spitalin Amerikan, i cili do të jetë edhe një mundësi më shumë për qytetarët e Kosovës, i cili do të jetë edhe një mundësi më shumë për punësimin e personelit shëndetësor dhe i cili nuk do t'i sjell dëm asgjë Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete Besa Baftija, ke pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Po, nënkryetar, se udhëzimi administrativ është ndryshuar në këtë e dimë. Mirëpo, prapë ministri nuk na dha përgjigje, të cilën përgjigje e ka dhënë edhe në komision, që Qeveria do të marrë vendim.

Prandaj, udhëzimet administrative ne e dimë se shkojnë konform ligjit, mirëpo Udhëzimet Administrative nuk bën që në atë mënyrë, në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës, apo në dëm të shëndetit publik.

Mirë, siç shihet kjo bashkëjetesë në mes të PDK-së dhe LDK-së është e kamotshme, sepse një vendim i tillë për hapjen e Spitalit Amerikan ka qenë i kamotshëm, qysh në vitin 2003, kur ish-komuna e Prishtinës apo... ka dhënë pëlqimin për dhënien e tokës në kuadër për këtë spital. Prandaj, siç jeni në dijeni të gjithë ju deputetë, po besoj edhe shumë qytetarë, kjo po bëhet për interesa klienteliste, po dihet se këtu po punon mafia, sepse kjo po bëhet në dëm të shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, kur dihet se 80% apo, po them edhe 90% të qytetarëve marrin shërbime në institucionet publike të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Rrahmani e ka fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Natyrisht se vendimi është marrë në Qeveri, sepse Ministria e Shëndetësisë është pjesë e Qeverisë. Unë jam anëtar i Qeverisë dhe si rrjedhojë edhe Qeveria është konsultuar në vazhdimësi për marrjen e këtij vendimi për licencim dhe nuk kemi asnjë të keqe që unë t'ua bëj informatën rreth këtij licencimi të Spitalit Amerikan në mbledhjen e parë që Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e thërret ministrin në takim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit ministër! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa! Urdhëro! Fjalën e ka deputetja Dërguti!

AIDA DËRGUTI: Kryesues, meqë kryeministri nuk është i pranishëm, nuk ka kuptim të lexoj kështu pyetje pas shpinës së tij.

KRYESUESI: Edhe një pyetje po i rikthehem. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit! Zonja ministre, më 1 shtator ka hyrë në fuqi Ligji për TVSH, në bazë të cilit TVSH-ja përshkallëzohet. Për disa prej artikujve ajo rritet nga 16 në 19%, për derisa, për disa të tjera, ajo zbritet në 8%. Në fakt për të gjithë artikujt për të cilët është rritur TVSH-ja, ajo menjëherë është reflektuar edhe në çmimet e artikujve, për deri sa një gjë e tillë nuk po reflektohet për artikujt për të cilët është zbritur TVSH-ja.

Për më tepër, ka pasur shumë shqetësime të klientëve, të cilët edhe i kanë dokumentar, ku çmimet e ndryshme kanë figuruar pranë artikullit dhe çmim tjetër ka paguar ai në arkën e pagesave.

Në kuadër të Ministrisë tuaj, ekziston edhe Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, e cila do të duhej të reagoje karshi këtyre shkeljeve.

Çka po bën kjo agjenci?

Cilat janë masat që i keni marrë sidomos ndaj këtyre bizneseve të cilat po i mashtrojnë klientët, në veçanti disa prej këtyre supermarketeve, të cilat edhe janë bërë publike nëpër media. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro ministre Bajrami!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Pantina, faleminderit për pyetjen!

Më lejoni në fillim të ju tregoj që në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nuk ka agjenci për mbrojtje të konsumatorit. Ka një Departament për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili i ka vetëm 3 persona të punësuar. Dhe në bazë të ligjit, ky departament është përgjegjës për hartimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit dhe harmonizimin e këtij legjislacioni me legjislacionin e BE-së, hartimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e konsumatorit;

organizimin e fushatave të ndryshme për vetëdijesimin e konsumatorëve dhe gjithashtu është përgjegjës për mbledhjen e ankesave nga ana e konsumatorëve dhe adresimin e tyre te organet përgjegjëse, siç janë, për shembull Inspektorati i Tregut, i cili prapë është në mandatin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare, Banka Qendrore, Rregullatori për Ujin e Mbeturina, Zyra e Rregullatorit për Energji, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati i Punës dhe shumë inspektorate të tjera, të cilat janë si në nivelin qendror ose lokal.

Thjesht, ky Departament i mbledh këto ankesa dhe i adreson mandej tek institucionet të cilat janë kompetente dhe mundohet që të marrë informata për të parë se si janë adresuar këto ankesa.

Sa i përket çështjes për ngritjen dhe zbritjen e TVSH-së për produktet e caktuara, më lejoni të ju tregoj se kemi pasur raste të tilla të raportimit. Deri më tani Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit ka marrë 18 ankesa të tilla, të cilat i ka adresuar te Inspektorati i Tregut dhe Inspektorati i Tregut menjëherë del në terren dhe 12 nga këto ankesa kanë dalë që të jenë në favor të konsumatorit dhe të vendoset të shqiptohen gjoba operatorëve ekonomikë. 4 prej tyre kanë rezultuar të jenë të pa bazuara dhe 2 janë në shqyrtim e sipër.

Kjo është gjendja e ankesave të konsumatorit. Në fakt operatorët ekonomikë, dënohen dhe u shqiptohen dënime nga ana e Inspektoratit për shkak të mospërputhjes së çmimit në arkë dhe në rafte ku ato ekspozohen mirëpo ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë jemi në proces të krijimit të bazës ligjore për publikimin e emrave të operatorëve ekonomikë të cilët kanë tendencë për t'i mashtruar konsumatorët sepse ne mendojmë që dënimi më i mirë mund të vjen nga vetë konsumatorët duke i abstenuar produktet dhe shërbimet e këtyre operatorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministre! Zonja deputete, keni pyetje shtesë?

SHQIPE PANTINA: Po! Faleminderit! Në fakt s'qenka agjenci, qenka departament. S'besoj që çon peshë kjo. Dhe, kërkesat po marrkan ta them te Departamenti, te zyra numër 2 dhe barten te zyra numër 3 në kuadër të Ministrisë suaj, që mund të jetë Inspektorati.

Ato ankesa janë shumë simbolike në krahasim me fenomenin, do ta quaja fenomen që po ndodh me rastin, sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për tatimin e vlerës së shtuar, shumë qytetarë ndoshta nuk i kanë adresuar direkt te Departamenti ankesat e tyre, por ata po vazhdojnë me i bë publike në forma tjera, kështu që Inspektorati do të duhej të reagoje edhe ex officio për të gjitha shkeljet të cilat janë bërë nga bizneset duke përfituar në këtë rast në kurriz të klientëve - konsumatorë.

KRYESUESI: Ministre, e doni fjalën? Urdhëro!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Zonja Pantina, ju pyetët se çfarë bën Departamenti ose Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, siç e quajttë ju. Në fakt, dallimi ndërmjet agjencisë dhe departamentit është i madh, sepse janë vetëm 3 persona dhe në agjenci do të kishte një pavarësi e përgjegjësi më të madhe dhe staf më shumë.

Më lejoni të ju tregoj se Inspektorati i Tregut, meqë ju pyetët për Departamentit për mbrojtje të konsumatorit, ju tregova se çfarë bëjnë ata. Përndryshe, Inspektorati i Tregut i ka planet e punës të cilat janë të aprovuara dhe assesi nuk bën inspektime vetëm duke u bazuar në kërkesat e konsumatorëve. Ata i kanë planet të cilat i realizojnë dhe numri i gjobave të cilat janë shqiptuar me këto inspektime ad hoc është shumë më i madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë deputetë, nuk kemi më pyetje. I trajtuam të gjitha pyetjet.

Pyetjet e deputetëve, që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për Informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve. Kështu thotë neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit dhe mund të ju them se e gjithë kjo po përsëritet se ka pyetje që përsëriten nga 5 herë e s'dalin atje. Do të thotë, unë e lexova çka shkruan këtu.

Dhe para se të vazhdojmë unë mendoj që edhe pyetjet kur t'i bëjmë është mirë të mos kalojmë në super motivime, e pastaj super motivimi po e humb edhe argumentin.

Unë e dëgjova këtu që u tha “ish Prishtina” dhe mua më bëri përshtypje, sepse s'ka ndërrua kurrë Prishtina, as s'ka ndërruar status, as s'e ka ndërruar emrin. Domethënë, unë e di, ai është motivim në të folur, por më mirë argumente. Ky është sugjerim i imi, kështu që po vazhdojmë.

Ju e keni marrë një rend dite, të marrë vesh në një mbledhje të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës në konsultim me grupet parlamentare.

Atëherë, kush e do fjalën? Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Deputetët, po edhe udhëheqja e Kuvendit e kanë marrë një shkresë nga kryeministri, zoti Mustafa dhe besoj që e kanë lexuar.

Por, më lejoni tash që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ta lexoj këtë kërkesë, tash edhe si kërkesë të Grupit Parlamentar të LDK-së, në formë të mocionit.

Ndër tjera, shkruan se me shkresën numër 152 të datës 10 shtator 2015, kryeministri i është drejtuar Kuvendit, përkatësisht kryetarit me kërkesë që në seancën e parë të sesionit vjeshtor të Kuvendit të informojë lidhur me marrëveshjet e arritura nga dialogu në Bruksel, të datës 25 gusht 2015.

Kryeministri në ndërkohë është informuar se është përcaktuar rendi i ditës për datën 17 shtator 2015, do të thotë për sot dhe në këtë rend dite është përfshirë edhe kjo pikë për raportimin e Qeverisë për këtë çështje.

Në ndërkohë, është kuptuar se një numër i anëtarëve të Qeverisë të cilët kanë qenë të kyçur në procesin e dialogut drejtpërdrejt apo në forma tjera, nuk do të jenë këtu me 17 shtator, prandaj është kërkesa e kryeministrit dhe ju kisha lutur që pikën e rendit të ditës - Raportimi i Qeverisë

së Republikës së Kosovës, lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015 të shtyhet për javën e ardhshme, mundësisht më 22 shtator.

Vlerësoj se është e dobishme për Kuvendin, por edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës që në seancë të marrin pjesë anëtarët e kabinetit qeveritar të cilët në mënyrë specifike kanë qenë pjesë e dialogut për çështje të veçanta për të cilat janë arritur marrëveshjet në mënyrë që raportimi të jetë sa më komplet. Ju faleminderit për mirëkuptim, që mes tjerash thuhet në shkresën e kryeministrit Mustafa, andaj ne si Grup Parlamentar propozojmë që për këtë pikë të vendosë seanca dhe të jetë më 22 shtator dhe ne propozojmë të jetë ora 11. Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Dëgjuam propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Kërkoj deklaratimet e grupeve tjera. Grupi i PDK-së. Kush e do fjalën? Zoti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit zoti nënkryetar!

Përshëndetje për kabinetin qeveritar,

Të nderuar e të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë mocion dhe është pro asaj që të shtyhet për javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ramush Haradinaj, nga AAK-ja, e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Përshëndetje edhe një herë, të gjithëve!

Tema e radhës tash ka qenë raportimi nga kryeministri Mustafa për marrëveshjet e nënshkruara, të fundit.

Kuptohet se ai, për një arsye apo tjetër, ka vlerësuar që mos të vjen. Ajo çfarë është me rëndësi, ai është në këtë objekt të Kuvendit dhe ne e pamë në mëngjes atë dhe kolegët tjerë.

Pra, nënkuptohet se diçka është kah fshihet dhe besoj që po i vjen era kësaj pune mjaftueshëm.

Mirëpo, po kthehem pak në kohë. Disa herë në këtë foltore kam provuar ta ftoj vetëdijen, ndërdijen, ndjen dhe shumëçka tjetër të deputetëve, pa dallim partie, për disa tema që mendoj se nuk janë të një partie, cilësdo qoftë, më e madhe, më e vogël.

Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, nuk është vetëm i Aleancës, nuk është vetëm imi, nuk është vetëm për vota të Aleancës në Dukagjin, por është e juaja kolegë, që jeni të këtij vendi. Dhe ju kam bërë thirrje disa herë, mos lejoni shefat tuaj të shkojnë gabim. Jam kanë këtu në kujdesin më të madh të ju ftoj të bëni një punë që është detyrë e juaja, mos me lejua me shkua gabim.

Marrëveshjet e fundit për asociacionin e komunave dhe marrëveshjet tjera të asociacionit të komunave serbe... shikoni, ne e kemi ngritur alarmin për mundësinë që asociacioni i komunave serbe të pajiset me kompetenca ekzekutive. A e dini çka ka ndodhë?! Është pajisur me kompetenca vendimmarrëse, që janë shumë më shumë se ato ekzekutive.

Në rast se dikush prej juve nuk e di që është kështu, kushdo qoftë, se ndoshta ka ndonjë matuf, atëherë kolegë të nderuar shihni për çka jam duke folur sot, se do të flasim prapë në këtë seancë.

Para disa kohe kam folur për demarkacionin, dhe kam thënë mos të lejojmë të shkojmë gabim, nuk e keni pritur që vjen dita e që shkojnë 12 mijë hektarë. Nuk do të shkojnë, s'ka me kalua kurrë.

Po edhe për asociacionin, mos lejoni të shkojë gabim. Le ta tërheq nënshkrimin Isa Mustafa, ku e ka qit, e të kthehemi në normalitet dhe të bëjmë pozitë - opozitë, e të flasim për korrupsion, të flasim investime dhe për vende të punës. Pa e tërhequr këtë nënshkrim nuk ka normalitet as në këtë Parlament, as në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Të merremi vesh se në bazë të nenit 40 pika 5, për rend dite flitet maksimalisht 3 minuta, me Rregullore gjithmonë. Glauk Konjufca, në emër të "Vetëvendosjes"!

GLAUK KONJUFCA: Vetë kryeministri i Kosovës e ka kërkuar këtë raportim. Nuk e ka kërkuar këtë raportim opozita por e ka kërkuar Isa Mustafa. Dhe pikërisht ai vet tash nuk vjen këtu për t'u ballafaquar me argumentet e opozitës.

Për më tepër se kaq, ai bile e jep një arsye banale. Thotë që nuk e kam Hashim Thaçin këtu. Isa Mustafa edhe vetë po dyshon a është kryeministër, apo jo. Pra, vetë Isa Mustafa ka kërkuar debat për 'Zajednicën', kurse tash po fshihet pas Hashim Thaçit i cili nuk ndodhet këtu, por ndodhet në Londër.

Unë e di që logjikisht, edhe me hierarki, zëvendëskryeministri ishte dashur të mos mund pa kryeministrin. Por, jo anasjelltas - të mos të mund kryeministri pa zëvendësin e tij, sepse hierarkia është në pyetje.

Isa Mustafa po thotë, unë jam këtu, por nuk e kam këtu zëvendësin dhe s'ka qëllua këtu, prandaj nuk mund të vi në Kuvend.

Kjo është skandaloze. Ne e dimë që Isa Mustafa ndodhet në Prishtinë. E kemi bile maksimalisht larg prej këtu, ku po flasim ne në Kuvendin e Republikës së Kosovës, vetëm 100 metra. 100 metra është objekti i Qeverisë dhe neve na duhet ai për marrëveshjen për 'Zajednicën', sepse nënshkrimi në 'Zajednicë' po thotë Isa Mustafa.

Nëse Isa Mustafa ka zgjedhur që të tallet me Kuvendin dhe me deputetët në këtë mënyrë, ne jemi këtu që të mos e lejojmë një degradim të tillë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Si grupe parlamentare opozitare, do ta pamundësojmë vazhdimin e mëtejshëm të seancës nëse kryeministri nuk vjen për tu ballafaquar për marrëveshjet me Serbinë.

Nuk kemi ardhur këtu të flasim për marka tregtare në kohën kur Kosovë është duke i shkuar 30% e territorit të vet. Kjo prepotencë e kryeministrit nuk tolerohet. Vetë e ka kërkuar këtë pikë, ne jemi përgatitur tash e sa kohë dhe tash thotë se nuk vjen, sepse nuk ka ardhur Hashim Thaçi.

Hashim Thaçi është e vërtetë që e ka gatuar ‘Zajednicën’, por Isa Mustafa e ka kurorëzuar ‘Zajednicën’, dhe kjo do të thotë që Isa Mustafa e ka vënë nënshkrimin, Isa Mustafa e mban përgjegjësinë dhe ne Isa Mustafën jemi duke e pritur për të ardhur në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi i Listës serbe, Slavko Simiq!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovane dame i gospodo, narodni poslanici!

Poslanička grupa podržava predlog Poslaničke grupe Demokratskog saveza Kosova da se 4 tačka dnevnog reda odloži za neku od narednih sednica. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Valdete Bajrami, për Grupin “Nisma”!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues!

Është për të ardhur keq se si po e fillojmë këtë sesion vjeshtor, me këtë joprezencë të kryeministrit dhe të kabinetit qeveritar dhe kjo po e dëshmon edhe një herë jo seriozitetin e këtij kryeministri ndaj deputetëve dhe ndaj qytetarëve.

Ju e dini shumë mirë që në mbledhjen e Kryesisë nuk e kemi pasur këtë pikë të rendit të ditës dhe kjo është futur me kërkesë të kryeministrit dhe tash të vjen një kërkesë tjetër e kryeministrit për tërheqjen e kësaj pike të rendit të ditës, është e pa arsyeshme dhe ne si Grup Parlamentar Nisma për Kosovën nuk e përkrah dhe ftojmë kryeministrin që të vjen këtu e të jep llogari për të gjitha ato marrëveshje qoftë që ai thotë nuk i ka trashëguar apo i ka trashëguar është problem i tij, por ai ka i ka qitur inicialet në ato marrëveshje, të vjen të raportojë dhe përndryshe të jep ose të deklarojë të heqë dorë krejt prej Qeverisë pasi që nuk është në gjendje ta udhëheqë vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mufera Shinik, në emër të Grupit “6+”!

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim,

Sayın bakanlar ve milletvekilleri,

Bu yılın sonbahar döneminin meclisimize hayırlı olmasını temeni ediyorum “6+” Parlamento Grubu olarak ve aynı zamanda LDK grubunun önerisini “6+” Parlamenter Grubu olarak desteklemekteyiz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë deputetë, e hedh në votim propozimin për rend dite, të LDK që kjo pikë të shkojë në mbledhjen me 22. Kush është për?

(Ndërprerje e incizimit)

Zotërinj deputetë,

Kush është për propozimin, çojeni dorën!

Kush është kundër?

(Disa deputetë të opozitës e pengojnë kryesuesin për ta vazhduar seancën.)

Po, por ky është rend dite!

(Ndërprerje e gjatë e incizimit)

I japim 10 minuta pushim, sepse këta zotërinjtë po kanë qejf të ndejnë këtu!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, seanca për sot mbaroi! Të hënën, Kryesia vendos kur vazhdon!
Faleminderit!

* * *

E martë, më 22 shtator 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 17 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Kërkoj falje! Po presim deri sa të vijë edhe Grupi Parlamentar i PDK-së, se po shoh që s'kanë ardhur, e vazhdojmë pastaj.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 17 shtator 2015.

Deputetë të nderuar,

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 21 shtator, ka vendosur që vazhdimi i seancës plenare të jetë vetëm me dy pika.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm aktualisht 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 30 e 31 korrik dhe më 3 gusht 2015, si dhe të seancave të jashtëzakonshme, të mbajtura më 3 gusht 2015 në orën 21:00 dhe në orën 23:15, urdhëroni!

Atëherë, meqë nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i Kosovës i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 30 e 31 korrik, më 3 gusht, dhe të seancave të jashtëzakonshme, të mbajtura më 3 gusht 2015 në orën 21:00 dhe në orën 23:15.

Jemi në pikën e vetme të rendit të ditës:

- Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa ka shprehur gatishmërinë që të raportojë në Kuvend lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel me datën 25 gusht, që kanë të bëjnë me konkluzionet e lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së energjisë të vitit 2013; Konkluzionet e Grupit punues për Urën, liria e lëvizjes; Planin i veprimit të Telekomit dhe asociacioni përkatësisht bashkësia e komunave me shumicë serbe; principet e përgjithshme, elementet kryesore.

Para se të ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, dëshiroj të theksoj se ky do të jetë një raportim i Qeverisë së Republikës së Kosovës në të cilën nuk do të ketë kufizime as në kohën e as në lirinë e deputetëve për të debatuar rreth kësaj çështjeje.

Ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, që të raportojë në Kuvend lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,
Qytetarë të nderuar dhe përfaqësues të mediave,
Së pari dëshiroj ta falënderoj Kuvendin dhe Kryesinë e Kuvendit që është pajtuar që kjo çështje të futet në rend dite.

Ju kërkoj falje që nuk është bërë kjo në javën e kaluar dhe arsyeja themelore ka qenë që do të ishte mirë të jetë kabineti qeveritar në numrin sa më të madh, veçmas njerëzve që janë marrë me këto çështje në mënyrë që informimi i juaj përkatësisht raportimi të jetë sa më përmbajtjesor dhe të arrihen qëllimet e saj.

Unë kam kërkuar nga kryetari i Kuvendit që ta informojë Kuvendin, përkatësisht ashtu siç Kryesia e Kuvendit ka formuluar që të raportojë për marrëveshjet e arritura në procesin e dialogut në Bruksel me datën 25 gusht të vitit 2015 që kanë të bëjnë me implementimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve.

Në Bruksel, më 25 gusht 2015, kemi përfunduar marrëveshjet për 4 dokumente:

1. Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë; Parimet e përgjithshme, përkatësisht elementet kryesore;
2. Konkluzionet e lehtësuesit të Bashkimit Evropian mbi implementimin e marrëveshjes për energji të vitit 2013, për heqjen e pengesave të Serbisë në zbatimin e marrëveshjes për energjinë;
3. Plani i veprimit të telekomunikacionit, dhe
4. Konkluzionet për Urën mbi Ibër, përkatësisht heqja e barrikadave nga ura e Mitrovicës.

Dua të theksoj para këtij Kuvendi se nuk kemi të bëjmë me marrëveshje të reja por kemi të bëjmë me precizime të veçanta që derivojnë nga marrëveshja e parë e ratifikuar me ligjin nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këto katër dokumente, që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjes së parë, janë nënshkruar nga dy shtetet, nga Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë dhe nga Bashkimi evropian përkatësisht nga kryeministrat e dy shteteve dhe përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian.

Akordimi mbi këto dokumente si dhe të gjitha tjerat në dialogun e Brukselit, janë arritur në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë, me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat njëherësh janë edhe mbështetës për zbatimin e plotë të tyre nga të gjitha palët.

Kjo pako është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e vendit, me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për dialogun në Bruksel numër 04/R001, të datës 10 mars 2015...

(Ndërhyrje e deputetëve të opozitës.)

...Ju kisha lutur të dëgjoni, e pastaj...

KRYETARI: Ju kisha lutur, lëreni të vazhdojë! Ju lutem! Turp, turp, turp!

(Disa deputetë të opozitës e gjuajnë kryeministrin me vezë.)

Japim pauzë! Një moment, turp është kjo! Dëgjoni, dëgjoni! E sigurimi, kush ju tha të hyni?! Ju lutem, dilni jashtë! Jashtë, sigurimi! Dilni jashtë, shpejt! Dëgjoni! Sigurimi, jashtë! Tash kemi 10 minuta pauzë! Ju lutem, Naser, Ismet, Raif, largohuni prej atje!

Tash ju kisha lutur për një pauzë prej 10 minutash. Deputetë, ju lutem, e kemi një pauzë prej 10 minutash!

Nuk ka nevojë ta dramatizojmë gjendjen. Ju lutem, jemi para publikut! Tash kemi 10 minuta pauzë. Nuk është kjo dinjitoze! Pra, kemi tash 10 minuta pauzë. Ju lutem! Me sinqeritet po ju lus, jo për hir tonin, por për hir të publikut. Pra, deputetë, 10 minuta pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Deputetë të nderuar,

Kishim filluar me vazhdimin e seancës. Me një apel të përbashkët, hajde Glauk. Ju lutem tjerë deputetë le të qëndrojnë në sall. Urdhëro!

Ftoj gjithë deputetë të qëndrojnë në vendin e vetë, mos të lëviz askush dhe deputetët e opozitës kush dëshiron por tjerë deputetë të mos lëvizin.

Kisha pasur dëshirë kryeministri të largohet prej salle, ose sigurimi i kryeministrit që të mos kem situata të tilla. Urdhëroni.

Unë po e hap mikrofonin, ju ftova. A ka mundësi të bashkëbisedojmë, të bëjmë një pauzë prej 15 minutash, të ulemi veç pesë minuta bashkarish, të ulemi bashkarish pesë minuta. Pa keqkuptim, faleminderit shumë! Po vetëm pesë minuta të bashkëbisedojmë pasi jemi edhe para publikut. Ju kisha lutë, të gjithë jemi të zgjedhur. Unë nuk kam asnjë të drejtë më shumë se ju si i zgjedhur këtu në këtë ulëse, as nuk e kam ndërmend mu shty me ju. A ka mundësi pesë minuta të bashkëbisedojmë, të ulemi ose unë vij në zyrën tuaj, ose ku ju dëshironi, pesë minuta të ulemi.

Po me kryeministrin keni punë, po pesë minuta po bashkëbisedojmë, për besë po bllokohemi shumë keq. Janë shumica, shumica është ajo pjesë, jo ne po e kuptojmë, jeni kundër.

GLAUK KONJUFCA: Shumica nuk ka të drejtë me të..., nuk është kjo punë e numrave.

KRYETARI: A e bashkëbisedojmë bashkë, ulemi, ju kisha lutë, 15 minuta pauzë, vetëm të ulemi pesë minuta edhe pastaj dalim me një përfundim të përbashkët. Nuk po marrim vendim tjetër.

Edhe unë po doja si kryetar i Kuvendit nuk mund ta bllokoj seancën që të mos vazhdojë për arsye se unë jam i zgjedhur prej atyre njerëzve edhe ata janë diku 87-88 deputetë. Ja unë kushtimisht, a mendoni se unë kam të drejtë ta ndal. Jo s'kam të drejtë. Me respekt, a e bëjmë një pauzë 15 minuta. Visar, je kryetar i partisë opozitare, Ramushi po qëndron atje, ulemi pesë minuta, ose ulemi në bazë të liderëve politikë.

VISAR YMERI: Nuk kemi çka të bisedojmë. Nuk mund dikush t'i thotë vetes kryeministër dhe ta mbrojë 'Zajednicën'. O Republikën, o 'Zajednicën', këta po e zgjedhin 'Zajednicën', le të shkojnë në Zajednicë.

ALBULENA HAXHIU: Le të shkojnë në Serbi.

KRYETARI: Po shkojmë 15 minuta në pauzë, ju kisha lutur vetëm të ulemi dy minuta në zyrë, pastaj e vazhdojmë nëse doni. Por, ne gjithsesi pa folur ndonjëherë nuk bën, shpijë e demokracisë. Ne duhet të bashkëbisedojmë për një marrëveshje.

GLAUK KONJUFCA: Demokracia ta mbrojë vendin tonë!

KRYETARI: Po, ajo është atdhetarizëm mbi demokracinë por ne të bisedojmë bashkë. 15 minuta pauzë ju kisha lutë të ulemi pesë minuta. 15 minuta pauzë. Pas 15 minutave vazhdojmë, ftoj kryetarët e grupeve parlamentare të ulemi në zyrën time.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Po shihni që gjendja nuk është shumë dinjitoze. Nuk e besoj se dikush që e do vendin e vet dhe ka vetëdije do të kishte dëshirë ta kishte një situatë të tillë dhe të gjendej para një situatë, aq më tepër kur shumë njerëz që janë këtu përpara janë njerëz që kanë dhënë shumë për vendin e vetë. Të njëjtën kohë, ashtu siç janë edhe pjesa tjetër, që gjithë jetën e kanë kaluar duke kontribuar për vendin e vet.

Realisht nuk do të kisha dëshiruar asnjëherë në jetë me ndodhë kjo situatë po ne jemi të detyruar me vazhdua seancën realisht edhe pse ju po e shihni se edhe kolegët e opozitës kanë shumë reagim. Ne po e bëjmë gjysmë ore pauzë edhe realisht pas pauzës unë jam vetëm i detyruar edhe

me i marrë masat të cilat janë me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Gjysmë ore pauzë, kisha lutë kolegët e opozitës në qoftë se ka mundësi më mirë do të ishte me bisedua, qoftë të përkrahjen, qoftë mos përkrahjen e asaj marrëveshje, po njerëzit kanë me dëgjua më mirë edhe peticionin në qoftë se dëshirojnë edhe nënshkruajnë më mirë njerëzit kur e shohin se për çka jena marrë vesh. Kështu nuk po ju la mundësinë njerëzve as me ditë çka është nënshkruar.

Ne e kemi bërë me qenë raportim me debat, keni me fol sa dëshironi, gjysmë ore, po duhet me fol se ky është vendi jonë, ne nuk luftojmë më, sa dëshironi me fol, sa herë dëshironi ta merrni fjalën për të replikuar.

(Ndërhyrje)

Po dëgjo marrëveshja nuk është proces, ne mundemi tani me e shkukurëzua atë marrëveshje sado që është reagimi i juaj.

(Reagim nga opozita)

Lëreni mundësinë për debat, ju kisha lutur, nuk po fitoni as ju me këtë veprim!

(Reagime)

Dëgjoni, jepni mundësinë njerëzve tjerë që janë jashtë nesh le të gjykojnë për atë marrëveshje për arsye se në qoftë se ju nuk e përkrahni, qoftë pozita që e ka përkrahë atë marrëveshje nuk është pjesë që tërhiqet nga individët, leni në gjykimin e qytetarëve në mënyrën që të keni mundësi ... në çdo ballafaqim. Pozicion më i rëndë nuk ka se sa mos me pas mundësi për atë çka kemi luftu, nuk kemi mundësi sot me fol, kurgjo tjetër këtu, as nuk po ju krijohet favor pozitës pse e ka nënshkrua as opozitës disfavor me kritikua. Po lini veç mundësi para njerëzve, thoni çka keni me thanë e keni kryeministrin, thoni një orë, dy orë.

(Ndërhyrje)

Po dëgjo, po thoni, po masë debatit kërkoni konkluzion, pse nuk po kërkoni. Po kërkoni masë debatit Visar, kërkoni masë debatit konkluzion, qitni në votim, ju nuk e dini as çfarë qëndrimi kanë shumica e deputetëve.

VISAR YMERI: ...t'i si kryetar i Kuvendit është deshtë me thanë ...ky institucion që udhëheqë duhet mu pyet.

KRYETARI: Si kryetar i Kuvendit e kam një rezolutë të vitit 2012 të cilën është votua po mi jep përkrahje Qeverisë, ka disa njerëz, ka mundësi edhe këtu që janë e kanë votua për.

VISAR YMERI: ... e kanë votuar një herë kundër, po e kthyet.

KRYETARI: Unë po mundona me qenë korrektë as për veti, se dikush mendon se po mundona me u tregua se më erdh mirë për shkak vetit me fitua, as vetëm për shkak të juve, për shkak atyre njerëzve që po na shikojnë, që kanë japë diçka. Po e bëjmë gjysmë ore pauzë. I kisha lutur liderët

ose kushdo të opozitës pesë minuta të bashkëbisedojmë asgjë nuk po dua më tepër edhe t'i shikojmë mundësitë për me vazhdua bashkërisht. Gjysmë ore pauzë, edhe pesë minuta, unë nuk po ndikoj asgjë te ju.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jemi në një situatë, është hera e tretë që bëjmë pauza për të vazhduar raportin e kryeministrit të Republikës së Kosovës për marrëveshjet e arritura në Bruksel.

Unë edhe një herë kisha kërkuar nga kolegët e opozitës, në qoftë se ka mundësi ta gjejmë një rrugëzgjidhje mënyrën që t'i hapet debati, mundësi debati që të kemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës që të na dëgjojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Në qoftë se e kishim pasur mirëkuptimin kishim vazhdua.

VISAR YMERI: Kryeministër duhet së pari me respektua Republikën në Kuvend edhe si kryeministër që po i thotë vetes ... edhe t'u nderojmë këtu të flasim për 'Zajednicën', po kjo është vendosur në funksion të 'Zajednicës' dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si kryeministër e as ky Kuvend si Kuvend i Republikës nëse insiston për ta pranuar 'Zajednicën'.

Kuvendi duhet mu kthye në normalitet e normalitet Kuvendi kthehet kur kthehet Republika në... me 'Zajednicën' nuk ka Republikë. Edhe ju kisha ftua edhe juve .. mos e ndalni mikrofonin po flasim në mënyrë transparente, ju kisha ftua edhe juve si kryetar i Kuvendit edhe me u deklarua për 'Zajednicën' dhe për ta mbrojtur Kuvendin nga kjo shkelje që po ia bën Qeveria me..., prej Kushtetutës të ligjet e të Kuvendi.

KRYETARI: E dëgjuat kryetarin e Lëvizjes "Vetëvendosje". Ju kërkoj falje, vetëm pak qetësi. Për t'i dëgjuar të gjithë bashkërisht do të ishte mirë t'i jap një rrugë debatit bashkërisht nuk do të ketë kufizime kohore, do të ketë fjalë për të gjithë, nuk do të ketë vetëm një herë fjalë po sa herë dëshironi. Kështu po krijohet pamundësia me të cilin kryeministri përkatësisht zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës edhe para qytetarëve po e tregojnë transparencën me tregua çka ka nënshkrua.

VISAR YMERI: Transparencë, që tri vjet janë tu fol, kur s'kanë tregua asgjë, çfarë transparence tash. Tash transparenca shihet në marrëveshje, s'kanë çka me na tregua këta. Unë po besoj që Kuvendi është në 120 deputetë që dinë shkrim lexim, kur s'dinë shkrim lexim organizoni një orë ndaras edhe ja u lexoni tekstin, përndryshe e kanë lexua tekstin.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Në rrethana të tilla ne do ta ndërprejmë seancën këtu. Faleminderit, për mirëkuptim.

Kërkoj nga gjithë qytetarët e vendit tonë që mos të krijohen keqkuptime edhe mos të kemi sa më pak raste të tilla. Do të vazhdojmë kur të ketë mundësi bashkëpunimi. Ftoj edhe përfaqësuesi e

opozitës që të jemi në një tryezë të përbashkët në Kuvendin e Republikës së Kosovës, qoftë ndërmjet liderëve pa kryetarin e Kuvendit, qoftë si do si dëshirojnë ata. Me kaq e përfundojmë seancën. Faleminderit!

* * *

E enjte, më 1 tetor 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 17 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju kërkoj falje për vëmendje edhe mediave! Ne i kemi këtu kolegët opozitarë, ndërsa e kemi pasur në vazhdim seancën, e në fakt e kemi një qëndrim të kolegëve opozitarë që të mos vazhdohet. Realisht, u përpoqa të bashkëbisedoj me kolegët këtu, të cilët i kam përpara meje, se është një cenim i demokracisë dhe i principeve mbi të cilat e kemi ndërtuar - bllokimi i punimeve të seancës, për arsye se nuk kemi hapësirë që para qytetarëve tanë t'i paraqesim qëndrimet tona, as ku të debatohet, në qoftë se kemi edhe dëshirë, edhe jemi për, ose në qoftë se kemi hidhërim dhe jemi kundër.

Si do që të jetë, qëndrimi nga kolegët opozitarë është bukur kategorik që të mos vazhdohet seanca. Janë 30 deputetë, e them edhe një herë publikisht - do t'ua jap edhe një herë fjalën kolegëve opozitarë. Sa të jem unë kryetar i Kuvendit, në këtë sallë nuk do të hyjë sigurimi në asnjë moment. Thjesht, i kisha lutur të kemi vëmendje dhe kulturë të sjelljes së deputetëve ndërmjet vete. Le ta shohë populli vetë kë e ka zgjedhur, si na ka zgjedhur dhe le të gjykojë në bazë të secilit prej nesh.

Edhe një herë, kjo nuk është mirë, sepse po mbyllet një institucion për të cilin të gjithë 99% e këtyre njerëzve, të cilët janë në këtë Parlament, pozitë e opozitë, kanë luftuar dhe kanë derdhur gjak.

Por, si do që të jetë, ja unë po ua jap fjalën edhe kolegëve opozitarë, le të flasin nga qëndrimi i tyre, e pastaj edhe unë do t'i them disa fjalë dhe do ta kërkoj një pauzë. Urdhëroni, Glauk dhe Donikë!

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më 25 gusht, Isa Mustafa e ka nënshkruar në Bruksel që t'ia japë Serbisë 30% të territorit të Kosovës.

Kurrkush nuk e ka derdhur gjakun, as në luftën çlirimtare, kurrkush nuk e ka mandatin as prej deputetëve, kurrkush nuk është zgjedhur që ta dëmtojë sovranitetin e shtetit tonë. Për këtë arsye, opozita është shumë e vendosur që ta bllokojë punën e Kuvendit derisa Isa Mustafa të vijë këtu dhe ta tërheqë nënshkrimin për "Zajednicën".

KRYETARI: Shefat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe LDK-së, doni ndonjë të deklaroheni? I kisha lutur deputetët për qetësi. Adem, mos krijë reaksione! Urdhëro në emër të PDK-së, e në fund të fundit, vetëm t'i marr qëndrimet, dhe ecim.

Dëgjo, qetë! Urdhëro, Adem, cili është qëndrimi? E lus përfaqësuesin e PDK-së, i kisha lutur kolegët e opozitës me qetësi dhe me dinjitet, po ashtu edhe të pozitës. Regjia, ju lutem! Adem, mund të flasësh edhe nga vendi. Edhe ju kisha lutur për hir të publikut, të kemi pak dinjitet, të tregojmë se kemi qëndrime politike, se nuk kemi qëndrime personale.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të falënderoj për qëndrimin dinjitoz, dashamirës, respektues të institucioneve, sakrificave të shumta të vendit dhe popullit tonë për të arritur për t'i ndërtuar institucionet.

Ju falënderoj shumë që s'po lejoni që ne vërtet të arrijmë aty nuk na takon të arrijmë. Qëndrimet e Grupit Parlamentar janë shumë të qarta. Ne asnjëherë të vetme nuk kemi qenë kundër debatit. Kemi qenë dhe jemi për debat për t'i ngrehur dhe për t'i diskutuar të gjitha çështjet bashkërisht. Kjo që po ndodh nga kolegët e nderuar të opozitës është një mohim i së drejtës së deputetit. Pakica po e pengon shumicën. Parlamenti i Kosovës i ka 120 deputetë dhe duhet t'u lejohet mundësia të gjithë deputetëve, të gjitha grupeve parlamentare, që t'i paraqesin qëndrimet e tyre, shqetësimet e tyre dhe së fundi ta marrin një qëndrim të përbashkët, ashtu siç na kishte takuar dhe kërkohet, e na takon si institucion vendimmarrës, e kurrësi të bëjmë përpjekje që në mënyrë të dhunshme t'i dëmtojmë interesat e vendit, interesat e shtetit tonë dhe t'i pengojmë institucionet tona dhe proceset tona të shkojnë drejt atje ku jemi nisur, e të mos i zhgënjëjmë edhe miqtë tanë, të cilët i kemi pasur, i kemi dhe duhet t'i kemi në mbështetje.

Prandaj, unë shpreh keqardhje dhe pajtohem plotësisht që të ndërpritet seanca, edhe në emër të Grupit Parlamentar, dhe ta thirrni mbledhjen e Kryesisë, shefat e grupeve dhe ta marrim një qëndrim të përbashkët. Bëjeni edhe një përpjekje për të gjetur gjuhë të përbashkët për ta zhbllokuar jetën institucionale, sepse bllokimi i Parlamentit nënkupton bllokimin e krejt shtetit të Kosovës, e ky nuk është interes as yni, as i opozitës.

Për "Zajednicën" dhe për të gjitha çështjet jemi të gatshëm të debatojmë, të diskutojmë dhe t'i ofrojmë gjithsecili argumentet e veta, e të marrim një qëndrim të përbashkët, e të mos bëjmë veprime të cilat nuk na kanë hije si deputetë, si përfaqësues të popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Kush është prej Grupit Parlamentar të LDK-së? Ju lutem, kush dëshiron, le t'i japë qëndrimet e grupeve parlamentare, e pastaj shkojmë në bazë të qëndrimit të përbashkët, në fund të fundit. Regjia, Arbeni!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se e kemi një situatë të veçantë. Unë e vlerësoj vullnetin tuaj për t'u treguar fleksibël, por mendoj që është e papranuar që deputeti të flasë prej mikrofonit dhe ulëses së kryetarit të Kuvendit, si pikë fillestare. Dhe, e dyta, unë mendoj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, se duhet të krijohen kushtet që Kuvendi t'i vazhdojë punimet e veta.

E shoh si shqetësues edhe qëndrimin e opozitës, por edhe shumica e deputetëve të Kuvendit janë të shqetësuar për rrjedhën e bisedimeve, edhe në Bruksel, por edhe për mënyrën se si po trajtohen çështjet këtu, por gjithsesi ne duhet të bisedojmë. Në qoftë se herën e parë nuk është lejuar që të mbahet seanca pa ardhur kryeministri, ka pasur një sqarim, në seancën e dytë nuk kanë dashur ta dëgjojnë kryeministrin se çfarë po thotë, e tash çka po duan?! Le të artikulohet dikush çka duan që Kuvendi ta dijë çka po do, në mënyrë që ta marrë një vendim. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi edhe Listën serbe dhe "6+". Lista serbe nuk dëshiron qëndrim. "6+", dëshiron qëndrim? Kemi qëndrime të tri grupeve parlamentare të opozitës për ta bllokuar

seancën, e kemi qëndrimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta ndërprerë seancën, e kemi qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së që ta vazhdojmë seancën.

Atëherë, unë e kisha kërkuar një pauzë në qoftë se ka mirësi dhe rregull. Do të ishte mirë që të takohet Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare në zyrën e kryetarit të Kuvendit.

Pauza është gjysmë ore.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Media të nderuara,

Publik i nderuar,

Po e shihni edhe vetë se është një atmosferë që nuk i ngjan denjësisht vendit ku duhet të kuvendohet dhe të marrim vendime. Nuk ka kurrfarë kushtesh. Në rrethana të tilla, unë do të dal në një konferencë për shtyp pas gjysmë ore, i ftoj mediet. Do ta ndërpresim seancën, as nesër nuk do të ketë seancë. Nga Kryesia dhe grupet parlamentare do të kërkoj që të takohemi javën e ardhshme.

Ajo çka dëshiroj të përçoj - një mesazh: Kuvendi nuk do bllokohet në të ardhmen pafundësisht. Ky do të jetë mesazhi të cilin dëshiroj ta dërgoj. Faleminderit!

* * *

E enjte, më 8 tetor 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 17 shtator

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po shihet se nuk ka kushte nga pjesa e foltores sime. Ambienti është çfarë është, prandaj e kaloj kryesimin e Kuvendit te nënkryetari, z. Xhavit Haliti.

(Drejtimin e mbledhjes nga ulëset e deputetëve e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

(Zhurmë dhe fishkëllima në sallë)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë seancën e mbetur, sot më 8 tetor 2015:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore Obiliq dhe rrethit të tij

Projektligji është propozuar nga deputeti Raif Qela, i mbështetur edhe nga 47 deputetë tjerë nënshkrues. Qeveria e Kosovës nuk i ka dërguar mendim Kuvendit lidhur me këtë projektligj. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në këtë rast kryetarët, që në cilësinë e propozuesit të paraqesin dhe arsyetojnë projektligjin.

Zoti Grabovci e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson si shumë të rëndësishëm këtë ligj, sepse ka të bëjë me shëndetin e qytetarëve të Obiliqit, prandaj ne i japim mbështetje në parim, edhe pse me papërgjegjësinë dhe pengesat e opozitës së zhurmshme.

KRYESUESI: Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Edhe ne si deputetë të Grupit Parlamentar të LDK-së e mbështetim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” e ka fjalën. Nuk e do fjalën. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Lista serbe? Në rregull!

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička grupa Srpske liste podržava ovaj zakon u nacrtu i mi čemo glasati za.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma”? “6+”?

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” podržava Nacrt zakona i glasače za njega.

KRYESUESI: Deputetë të tjerë s’ka të paraqitur. Në sallë janë 94 deputetë. Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi në votim për miratimin në parim të Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rrethinës.

Votojmë tash! E përsëris votimin edhe një herë në mungesë të kartelave të disa deputetëve. A ka dikush që s’ka kartelë? Jo me dorë jo, kush s’ka kartelë paraqituni. Votojmë tash! Edhe një herë e përsëris, i kemi dy vota për pa kartelë.

Atëherë konstatoj se me 63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rrethinës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërimet e origjinës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar...

KRYETARI: I nderuar kryesues, ndërpritet seanca, pauzë! Dëgjoni, ju lutem, pauzë 15 minuta. A doni të vazhdoni? Vazhdoni!

KRYESUESI: Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Hykmete Bajrami, që para deputetëve...

KRYETARI: Ju lutem, deputetët e opozitës të mos ndërmarrin veprime konfrontimi fizik. Qëndroni, refuzoni, por mos ndërmerrni konfrontim fizik!

KRYESUESI: Hykmete, e ke fjalën. Ministrja s’e ka fjalën. Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, Muhamet Mustafa e ka fjalën për ligjin.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Deputetë të opozitës, mbani dinjitetin dhe qëndroni në nivelin tuaj!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, pas shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare e shqyrtoi projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet këtë raport me rekomandime: Komisioni konstatoi se ndërmjet dy leximeve duhet të shqyrtohet mundësia e racionalizimit të procedurave

administrative. Sugjerohet që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe asociacionet e biznesit, krahas procedurave të zbatimit të ligjit të ndërmarrin aktivitete dhe të zhvillojnë programe në ngritjen e rëndësisë të zhvillimit, të mbrojtjes së markave tregtare, origjinës gjeografike dhe treguesve gjeografikë.

Komisioni, pas shqyrtimit të parim Projektligjit për treguesit gjeografikë, emërtimet e origjinës, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 56 të Rregullores së Kuvendit dhe njëzëri e miratoi në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, zoti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje në parim.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet në parim.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”? Nuk do. Grupi Parlamentar i AAK-së, Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička grupa Srpske liste podržava ovaj zakon u nacrtu i mi ćemo glasati za.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma”? “6+”?

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” podržava raport.

KRYESUESI: Deputetët nuk janë paraqitur, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me elektronikë, 5 janë pa elektronikë. Atëherë, me 69 vota për: 64 me elektronikë, 5 pa kartelë, konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërimet e origjinës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Zëvendëskryeministri Kuçi nuk është këtu, në emër të Komisionit FunkSIONAL zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 16. 9. 2015, e shqyrtoi projektligjin dhe i rekomandon seancës që të miratohet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e grupeve parlamentare, zoti Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: E mbështetim dhe jemi pro këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”? Nuk e dëshiron fjalën. Grupi Parlamentar i AAK-së? Nuk e dëshiron fjalën. Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička grupa Srpske liste podržava ovaj zakon u načelu i glasaćemo za.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma”? “6+”?

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” podržava u načelu ovaj zakon i glasaće za njega.

KRYESUESI: Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron fjalën. Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi në votim. Lus regjinë që të votojmë. Votojmë tash!

Faleminderit! 62 vota me elektronikë, 3 pa kartelë. Me 65 vota për, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe të ushtrimit e funksionit publik.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë termike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin për Zhvillimin Ekonomik, por nuk qenka këtu. Atëherë kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Mustafa, do t’i paraqesë vërejtjet e veta për ligjin.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit në mbledhjen plenare, e ka trajtuar këtë ligj dhe ka konstatuar si vijon:

Komisioni konsideron se ngrohja apo energjia termike e ka rëndësinë e vet dhe ndërmjet dy leximeve ky ligj ka nevojë për disa sqarime. Sidomos duhet të qartësohet çështja e shthurjes të liberalizimit të tregut në fushën e ngrohjes të energjisë termike për ta siguruar një treg të lirë dhe një konkurrencë të barabartë me interes të furnizimit të qytetarëve të Kosovës me ngrohje.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të këtij projektligji, vlerësoi se ky ligj i plotëson të gjitha kushtet e parapara, përkundër zhurmës që e kemi këtu, që ky ligj të aprovohet.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje në parim këtij projektligji.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së i jep mbështetje këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”. Grupi Parlamentar i AAK-së. Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička grupa Srpske liste podržava ovaj zakon u načelu i glasaćemo za.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma”? “6+”?

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” podržava u načelu ovaj zakon i glasaće za njega.

KRYESUESI: Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për energjinë termike. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se 63 vota me elektronikë, 3 pa kartelë, gjithsej 66 vota, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për energjinë termike.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Fondit kosovar për dizajnim industrial

Në emër të Komisionit Funkcional, zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe i ka propozuar Kuvendit miratimin në parim. Komisioni ka konstatuar se me aprovimin e Projektligjit për dizajnin industrial po përmbyllet me sukses një pako e ligjeve që i siguron një mbrojtje të pronësisë industriale, e cila është shumë e rëndësishme për tërheqjen e investimeve në fushën e mbrojtjes dhe dizajnit industrial dhe stimulimin e krijimtarisë në Kosovë.

Ky ligj ka adresuar në mënyrë më të mirë sa u përket procedurave të përafrimit dhe legjislacionit evropian. Mirëpo, duhet të shqyrtohet çështja e periudhës së dizajnit, e cila mbrohet për pesë vjet dhe duhet kërkesë administrative për 25 vjet, gjë që mund ta rrisë administrimin në këtë fushë. Ne kërkojmë që kjo të rishqyrtohet. Komisioni, pas shqyrtimit, propozon që ky ligj të aprovohet.

Deputetë të opozitës, ruajini mushkëritë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Edhe ne Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështetim në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, Grupi Parlamentar i AAK-së? Lista serbe?

SLAVKO SIMI: Parlamentarna grupa Srpske liste podržava ovaj zakon u načelu i glasaćemo za.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Nisma”? “6+”?

DUDA BALJE: Parlamentarna grupa “6+” podržava u načelu ovaj zakon i glasaće za njega.

KRYESUESI: E bëjmë deklarinimin me votim. Votojmë tash! Ju lutem, votoni tash! Faleminderit!

Me 63 vota me elektronikë, 3 pa elektronikë, gjithsej 66 vota për, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për dizajnim industrial.

Komisioni funksional e di detyrën.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore

Fjalën për ta elaboruar e ka zoti Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit Funksional.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryesues,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari opinion dhe votues tanë,
Ju lutem, që t'i ndërmerrni të gjitha masat që të krijoni kushte për punë normale në këtë Kuvend.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL, pas shqyrtimit të parë të projektligjit, propozon që mbledhja plenare e Kuvendit ta aprovojë këtë projektligj. Komisioni e vlerësoi këtë projektligj të një rëndësie të posaçme, ngase e kompletton pakon e re të masave të përmirësimit të klimës së biznesit dhe nxitjes së investimeve. Krijohet një ligj i cili do të mundësojë lehtësim për qasjen e financave të mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe ky është një moment i ri në këtë sferë, në trajtimin e mëtejshëm deri në aprovim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përgjegjësisë për pagesë, duhet të rishikohen normat kur një bankë është e kualifikuar që të pretendojë për të realizuar garancitë që sigurohen në këtë fond.

Të shqyrtohet nevoja për përkufizimin e kriterëve të formimit të tarifës së garancisë, në mënyrë që ky instrument duhet ta ketë një ndikim pozitiv të normave të interesit. Po ashtu, duhet të sqarohet çështja e dividendës dhe përfitimeve në bazë të këtij fondi dhe natyra e këtyre përfitimeve. Komisioni, pas shqyrtimit në parim të projektligjit për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 56 të Rregullores dhe njëzëri e miratoi për aprovim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Ju ftoj që të votoni me dorë, kush është për? A ka kundër? Miratohet projektligji për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore.

Me kaq përfundon seanca e sotme. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*